

Raporti Willowbank: Raport rreth një Konsultimi mbi Ungjillin dhe Kulturën

Mbajtur në Willowbank, Somerset Bridge, Bermuda
Nga data 6 deri 13 Janar 1978
Sponsorizuar nga Grupi Teologji dhe Edukim i Lozanës
Copyright © 1978
Komiteti i Lozanës për Ungjillizimin Botëror
Përkthyer në Shqip: **Joan Qesteri**, Sept. 2002, Rev. 1.0

Përmbajtja

Hyrja

1. Baza Biblike e Kulturës
 2. Përkufizimi i Kulturës
 3. Kultura në Zbulesën Biblike
 4. Kuptimi i Fjalës së Perëndisë Sot
 5. Përmbajtja dhe Komunikimi i Ungjillit
 6. Kërkohen: Lajmëtarë të përlurur të Ungjillit
 7. Konvertimi dhe Kultura
 8. Kisha dhe Kultura
 9. Kultura, Etika e Krishterë dhe Mënyra e Jetesës
- Përfundimi

Hyrja

Procesi i komunikimit të ungjillit nuk mund të ndahet nga kultura njerëzore nga e cila vjen, ose nga ajo nga e cila do të shpallet. Ky fakt përbën një nga shqetësimet e Kongresit të Lozanës mbi Ungjillizimin Botëror në Korrik të 1974. Kështu Grupi Teologji dhe Edukim i Komitetit të Lozanës u mbledh në një konsultim mbi këtë temë që u takua në janar 1978. Kjo solli 33 teologë, antropologë, linguistë, misionarë dhe pastorë sëbashku nga të gjitha gjashtë kontinentet për të studiuar “Ungjillin dhe Kulturën.” I bashkë sponsorizuar nga Grupi i Punimit të Strategjive të Komitetit të Lozanës, pati katër qëllime:

1. Të zhvillojmë një kuptim të ndërlidhjes të ungjillit dhe kulturës me referencë të veçantë të zbulesa e Perëndisë, të interpretimi dhe komunikimi ynë i tij, dhe të përgjigjja e dëgjuesve në kthimin e tyre në besim, kishave dhe mënyra e tyre të jetesës.
2. Të mendojmë në mënyrë kritike rreth rrjedhëve të komunikimit të ungjillit në mënyrë ndërkulturore.
3. Të identifikojmë mjetet që duhen për një komunikim më të përshtatshëm të ungjillit.
4. Të ndajmë frytet e konsultimit me udhëheqës të krishterë në kishë dhe mision.

Ky raport pasqyron përmbajtjen e 17 punëve të shkruara të qarkulluara paraprakisht, përmbledhje të tyre dhe reagime ndaj tyre të mbajtura gjatë konsultimit, si dhe shumë këndvështrime të shprehura në diskutime plenare dhe grupe.

Programi ynë për gjashtë ditë ishte shumë i ngarkuar, dhe ne punuam nën presion të madh. Si rrjedhim, pyetjet themelore metodologjike rreth presupozimeve dhe procedurave të teologjisë dhe shkencave shoqërore, dhe rreth një mënyre të drejtë për marrdhënijen midis të dyjave, nuk u shqyrtuan dot; dhe pati pika në të cilat diskutimi ynë e pasqyroi qartë këtë fakt. Gjithashtu, shumë pyetje të cilat u ngritën u desh të lihen mënjanë, dhe shumë debate të veçanta duhet të mbylleshin gjatë vazhdimit. Ne jemi të ndërgjegjshëm, pra, se ajo që themi është deri në një masë e kushtëzuar, dhe mund të duhet të mprehet dhe thellohet në pika të ndryshme në dritën e punës së ardhshme. Si shtesë, ne përdorim një numër përgjithësimesh; duhen më shumë studime praktike për të parë si ti lidhim këto situata të veçanta.

Përpara përfundimit të Konsultimit, ne kaluam një kohë së bashku duke punuar në draftin e raportit dhe duke e korigjuar atë. Dokumenti përfundimtar është një Raport, jo një Thënije apo Deklaratë; kështu që asnjë nga ne nuk e ka nënshkruar. Por ne e dërgojmë si një përmbledhje e asaj që ndodhi në Willowbank, dhe ja rekomandojmë vëllezërve të krishterë në të gjithë botën për studim dhe veprim të duhur.

1. Baza Biblike e Kulturës

“Për arsye se njeriu është krijesa e Perëndisë, ca nga kultura e tij është e pasur në bukuri dhe mirësi. Për arsye se është i rënë, e gjithë kultura është e njollosur me mëkat dhe një pjesë e saj është demonike.” (Konventa e Lozanës, par. 10)

Perëndia e krijoi njeriun mashkull dhe femër në pamjen e tij duke i dhënë atyre aftësi të dukshme njerëzore—mendore, morale, sociale, krijuese dhe shpirtërore. Ai i tha gjithashtu atyre të kenë fëmijë, të mbushin tokën dhe ta pushtojnë atë (Zan. 1:26-28). Këto urdhëresa hyjnore janë zanafilla e kulturës njerëzore. Themelore për kulturën janë kontrolli ynë i natyrës (domethënë, ambjenti ynë) dhe zhvillimi ynë i formave të organizimit shoqëror. Përderisa ne përdorim fuqinë tonë kreative për t’iu bindur Perëndisë, ne lëvdojmë Perëndinë, i shërbejmë të tjerëve dhe përmbushim një pjesë të rëndësishme të fatit tonë mbi tokë.

Tani megjithatë, ne jemi të rënë. E gjithë puna jonë është e shoqëruar nga djersa dhe mundimi (Zan. 3:17-19), dhe është shpërfytyruar nga egoizmi. Kështu asnjë nga kulturat tona nuk është e përsosur në të vërtetë, bukuri ose mirësi. Në zemër të çdo kulture —nëse ne e identifikojmë këtë zemër si feja apo botë-vështrimi—ka një element egocentrizmi, e adhurimit të njeriut ndaj vetes. Prandaj një kulturë nuk mund të vihet nën sundimin e Krishtit pa një ndryshim radikal të besnikërisë së saj.

Për të gjitha këto, pohimi që ne jemi bërë në pamjen e Perëndisë akoma ka vlerë (Zan. 9:6; Jak. 3:9), megjithëse ngjashmëria hyjnore është shpërfytyruar nga mëkati. Dhe Perëndia akoma pret prej nesh të kemi administrim mbi tokën dhe krijesat e saj (Zan. 9:1-3, 7), dhe në hirin e tij të pamasë i bën të gjithë njerëzit krijues, me burime dhe fryte në përpjekjet e tyre. Kështu, megjithëse Zanafilla 3 shënon rënien e njerëzimit, dhe Zanafilla 4 vrasjen e Abelit nga Kaini, janë pasardhësit e Kainit ata që përshkruhen si novatorët e kulturës, duke ndërtuar qytetet, shumimin e bagëtisë, dhe shpikjen e instrumentave muzikore dhe veglave të hekurit (Zan. 4:17-22).

Shumë nga ne të krishterët ungjillorë kanë qenë në të kaluarën tepër negativë ndaj kulturës. Nuk e harrojmë rënijen dhe humbjen njerëzore të cilat thërrasin për shpëtim në Krishtin. Por akoma ne duam ta fillojmë këtë Raport me një pohim pozitiv të dinjitetit njerëzor dhe arritjeve kulturore të njerëzve. Kudo që qëniet njerëzore fillojnë të zhvillojnë organizimin e tyre shoqëror, artin dhe shkencën, bujqësinë dhe teknologjinë, krijueshmëria e tyre pasqyron atë të krijuesit të tyre.

2. Përkufizimi i Kulturës

Kultura është një term i cili nuk është i ndjeshëm lehtë në përkufizim. Në kuptimin më të gjërë, thjesht do të thotë mënyra e organizuar në të cilën njerëzit bëjnë gjërat sëbashku. Nëse do të ketë ndonjë jetë të përbashkët dhe veprim të bashkuar, duhet të ketë një marrveshje, e folur apo jo, për shumë gjëra. Por termi “kulturë” nuk përdoret në përgjithësi përveç kur njësia në fjalë është më e madhe se familja, bërthamë apo e zgjeruar.

Kultura nënkupton një masë homogjeniteti. Por, nëse njësia është më e gjërë se klani ose një fis i vogël, kultura do të përfshijë brenda vetes një numër nënkulturash, dhe nënkultura nënkulturash, brenda të cilave një shumëllojshmëri dhe larmi e gjërë është e mundur. Nëse ndryshimet kalojnë një kufi të caktuar, një kundërkulturë do vijë në jetë, dhe kjo mund të krijojë një proces shkatërrues.

Kultura i lidh njerëzit bashkë për një periudhë kohe. Merret nga e kaluara, por jo nga ndonjë proces i trashëgimisë natyrore. Duhet të mësohet së pari nga çdo brez. Kjo bëhet nga një gjërësisht nga një proces thithje nga ambjenti shoqëror, sidomos në shtëpi. Në shumë shoqëri disa elementë të veçantë të kulturës janë komunikuar drejt në rite fillimi, dhe nga shumë forma të tjera mësimi të hapur. Veprimi në bazë të kulturës është zakonisht në nivelin e nën ndërgjegjjes.

Kjo do të thotë se një kulturë e pranuar mbulon gjithçka në jetën njerëzore.

Në qendër të saj është një botë vështrim, që është, një kuptim i përgjithshëm i natyrës së gjithësisë dhe vendit të njeriut në të. Kjo mund të jetë “fetare” (rreth Perëndisë, ose perëndive dhe shpirtave, dhe marrdhënies tanë me to) ose mund të shprehë një koncept laik të realitetit, si në shoqërinë marksiste.

Nga ky botë-vështrim themelor rrjedhin të dy standartet e gjykimit të vlerave (të atyre që janë të mira në mënyrën e të dëshiruarit, ato që janë të pranueshme si në përputhje me vullnetin e përgjithshëm të komunitetit, dhe të të kundërve) dhe standartet e sjelljes (rreth marrdhënjeve midis individëve, midis gjinive dhe brezave, me bashkësinë dhe ata jashtë bashkësisë).

Kultura është e lidhur ngushtë me gjuhën, dhe është e shprehur në fjalë të urta, legjenda, tregime popullore, dhe forma të ndryshme arti, të cilat bëhen pjesë e inventarit mendor të të gjithë anëtarëve të gupit. Ajo qeveris veprimet e ndërmarra në bashkësi--veprime adhurimi apo të mirqënies popullore; ligje dhe administrimi i ligjit; veprimtari shoqërore si vallëzime dhe lojëra; njësi më të vogla vepruese si klube dhe shoqëri, lidhje për një larmi të gjërë qëllimesh të përbashkëta.

Kulturat kurrë nuk janë statike; kanë një proces të vazhdueshëm ndryshimi. Por ky duhet të jetë aq i shkallëzuar sa të ndodhë brenda normave të caktuara; përndryshe

kultura do ndërprehet. Dënimi më i rëndë që mund ti jepet kryengritësit është përjashtimi nga bashkësia shoqërore e përkufizuar në mënyrë kulturore.

Burrat dhe gratë kanë nevojë për një jetesë të bashkuar. Marrja pjesë në kulturë është një nga faktorët që i jep atyre një ndjenjë që i përkasin diçkaje. I jep një ndjenjë sigurie, identiteti, dinjiteti, të qenit pjesë e gjithësisë së madhe, dhe ndarjes si në jetën e brezave të kaluar ashtu edhe në pritjen e shoqërisë për të ardhmen e saj.

Gjurmë të dhënash biblike për kuptimin e natyrës njerëzore gjehen në përmasën e treanshme të njerëzve, tokës, dhe historisë, mbi të cilat Dhjata e Vjetër përqendrohet. Etnikja, territorjalja dhe historikja (kush, ku dhe prej ku jemi) dalin aty si një burim i trefishtë i formave ekonomike, ekologjike, sociale dhe artistike të jetës në Izrael, të formave të punës dhe prodhimit, kështu rrjedhimisht të pasurisë dhe mirqënijes. Ky model jep një perspektivë për interpretimin e kulturave.

Ndoshta të përpiqemi ti përmbledhim këto kuptime të ndryshme si më poshtë: Kultura është një sistem i njësuar besimesh (rreth Perëndisë ose realitetit ose kuptimit përfundimtar), vlerash (rreth atyre që janë të vërteta, të mira, të bukura dhe normative), traditash (si të sillemi, marrdhënijet me të tjerët, e folura, lutja, veshja, puna, lojtja, tregtimi, bujqësia, të ngrënët, etj.), dhe institucionesh të cilat i shprehin këto besime, vlera dhe zakone (qeveria, sallat e gjyqit, tempujt ose kishat, familja, shkollat, spitalet, fabrikat, dyqanet, organizatat, klubet, etj.), të cilat lidhin një shoqëri si të tërë dhe i jep një ndjenjë identiteti, dinjiteti, sigurie dhe vazhdimësie.

3. Kultura në Zbulesën Biblike

Hapja e personit të Perëndisë që ai e bëri vetë në Bibël u dha në fjalët e kulturës së dëgjuesit. Kështu ne e kemi pyetur veten çfarë drite hedh kjo në detyrën tonë të komunikimit ndër-kulturor sot.

Shkrimtarët biblikë përdornin në mënyrë kritike çfarëdo lloj materiali që kishin të disponueshëm për shprehjen e mesazhit të tyre. Për shembull, Dhjata e Vjetër i referohet disa herë bishës ujore Babilonase të quajtur “Leviatan”, ndërsa forma e “besëlidhjes” së Perëndisë me popullin e tij i ngjan “traktatit” të Suzeranit të vjetër Hitit me vasalët e tij. Shkrimtarët gjithashtu përdorin rastësisht shëmbëlltyrat konceptuale të universit me “tre rrota”, megjithëse nuk afirmojnë në këtë mënyrë kozmologjinë para Kopernikut. Ne bëjmë një gjë të njëjtë kur flasim për diellin që “ngrihet” dhe “ulet”.

Në mënyrë të ngjashme, gjuha e Dhjatës së Re dhe format e mendimit janë të thelluara si në kulturën helene ashtu edhe në atë hebreë, dhe Pali duket sikur ka huazuar nga fjalori grek i filozofisë. Por procesi nga i cili autorët biblikë kanë huazuar fjalë dhe figura nga ambjenti i tyre kulturor, duke i përdorur në mënyrë kreative, kontrollohej nga Fryma e Shenjtë kështu që i pastruan ato nga implikime jo të vërteta dhe të liga dhe kështu i transformuan ato në mjete të së vërtetës dhe mirësisë.

Këto fakte të padyshueshme ngrenë një numër pyetjesh me të cilat ne jemi marrë. Këtu përmendim pesë:

A. Natyra e frymëzimit biblik

A është përdorimi i fjalëve të autorit biblik dhe i ideve të kulturës së tyre të papërshtatshme me frymëzimin hyjnor? Jo. Ne kemi marrë shënim zhanret e ndryshme literare të Shkimit, dhe të formave të ndryshme të procesit të frymëzimit të cilat ato nënkuptojnë. Për shembull, ka një ndryshim të gjerë në formë midis punëve të

profetëve, marrja e vizioneve dhe fjalëve të Perëndisë, dhe historianëve dhe shkruajtjes së letrave. Megjithatë, i njëjti Shpirt në mënyrë unike i ka frymëzuar të gjitha. Perëndia e ka përdorur njohurinë, eksperiencën dhe sfondin kulturor të autorëve (megjithëse zbulosa e tij vazhdimisht i tejkalon këto), dhe në çdo rast rezultati ishte i njëjtë, domethënë Fjala e Perëndisë nëpërmjet fjalëve të njeriut.

B. Forma dhe kuptimi

Çdo komunikim ka si një kuptim (çfarë duam të themi) ashtu edhe një formë (si e themi). Të dyja – forma dhe kuptimi – gjithmonë përkasin së bashku, në Bibël dhe në libra dhe shpallje të tjera. Si atëherë duhet të përkthehet mesazhi nga një gjuhë në gjuhën tjetër?

Një përkthim fjalë për fjalë i formës (korrespondencë formale) mund të fshehë ose të shtrembërojë kuptimin. Në raste të tilla, mënyra më e mirë është të gjehet në gjuhën tjetër një shprehje e cila ka një efekt të afërt me atë që dëgjuesit patën në kohën e tyre. Kjo mund të përfshijë ndyshimin e formës në mënyrë që të ruajë kuptimin. Kjo quhet “ekuivalencë dinamike”. Merrni parasysh, përshembull, përkthimin RSV të Rom. 1:17, i cili thotë që në ungjillin “drejtësia e Perëndisë zbulohet nëpërmjet besimit për besim.” Kjo jep një interpretim fjalë për fjalë të greqishtes origjinale, domethënë, një përkthim “korrespondencë formale”. Por ajo i lë kuptimet e fjalëve greke “drejtësi” dhe “nga besimi në besim” të paqarta. Një përkthim si TEV – “ungjilli zbulon si Perëndia i vë njerëzit në rregull me veten: është nga besimi nga fillimi në fund” – e braktis parimin e korrespondencës një-në-një midis fjalëve greqisht dhe anglisht; por shpreh kuptimin e fjalisë fillestare më saktësisht. Përpjekja për të prodhuar një përkthim të tillë “ekuivalencë dinamike” mund të sjellë përkthyesin në një kuptim më të thellë të Shkrimit, si dhe ta bëjë tekstin më të kuptueshëm për njerëzit e një gjuhe tjetër.

Disa nga format biblike (fjalë, figura, metafora) duhen ruajtur, sepse janë të simbole të përsëritshme të rëndësishme në Shkrime (p.sh. kryqi, qengji ose kupa). Duke mbajtur formën, përkthyesit do përpiqen të nxjerrin në pah kuptimin. Për shembull, në përkthimin TEV të Markut 14:36 – “hiqe këtë kupë vuajtjeje nga mua” – forma (p.sh. figura e “kupës”) ruhet, por fjala “vuajtjeje” është shtuar për të qartësuar kuptimin.

Duke shkruajtur në greqisht, autorët e Dhjatës së Re përdorën fjalë që kishin një histori të gjatë në botë, por i veshën atyre kuptime të krishtera, si kur Gjoni i referohet Jezusit si “Logos-i”. Ishte një procedurë e rrezikshme, sepse “logos-i” kishte një sërë kuptimesh në letërsinë dhe filozofinë greke, dhe konceptet jo të krishtera që e shoqëronin pa dyshim i ndenjën afër. Kështu Gjoni e vendosi titullin nën kontekstin e mësimit, duke afirmuar që Logos ishte në fillim, ishte me Perëndinë, ishte Perëndi, ishte agjenti i krijimit, ishte drita dhe jeta e njerëzve, dhe u bë qenije njerëzore (Gjoni 1:1-14). Në të njëjtën mënyrë, disa të krishterë indianë kanë rrezikuar në marrjen borxh të fjalës sanskrit “avatar” (zbritje), e përdorur në hinduizëm për të ashtuquajturat “mishërime” të Vishnu, dhe i kanë zbatuar, me masa sigurie të shpjeguara me kujdes, për mishërimin e vetëm të Perëndisë në Jezus Krishtin. Por të tjerë kanë refuzuar të bëjnë këtë, në baza që nuk ka mënyrë ruajtje të mjaftueshme për të parandaluar keqkuptimin.

C. Natyra normative e Shkrimeve

Konventa e Lozanës deklaroi që Shkrimi është “pa gabim në gjithçka që afirmon” (para. 2). Kjo shtron përpara nesh detyrën serioze të të kuptuarit se çfarë pohon

saktësisht Shkrimi. Kuptimi thelbësor i mesazhit biblik duhet të ruhet me çdo kusht. Megjithëse disa nga format origjinale në të cilat mund të ndryshohen për hir të komunikimit ndër-kulturor, ne besojmë që edhe ata gjithashtu kanë një cilësi të duhur normative. Sepse Perëndia vetë i zgjodhi ata si ndërmjetës plotësisht të duhur të zbulesës së tij. Kështu, çdo formulim dhe shpjegim i ri në çdo brez dhe kulturë duhet kontrolluar për besnikëri duke iu kthyer origjinalit.

D. Kushtëzimi Kulturor i Shkrimeve

Ne nuk kemi pasur mundësinë ti kushtojmë aq kohë sa kemi dashur problemit të kushtëzimit kulturor të Shkrimeve. Ne kemi rënë dakort që disa urdhëresa biblike (p.sh., rreth mbulimit me vello të grave në publik dhe larjes së këmbëve të njëri tjetrit) i referohen disa zakoneve kulturore tashmë të vjetëruara në shumë vende të botës. Duke u vënë përballë teksteve të tilla, ne besojmë që përgjigjja e duhur nuk është as një bindje skllavërore fjalë për fjalë as një indiferencë e papërgjegjshme, por në rradhë të parë një dallueshmëri kritike e kuptimit të brendshëm të tekstit pastaj një përkthim i tij në kulturën tonë. Për shembull, kuptimi i brendshëm i urdhëresës për të larë këmbët e njëri tjetrit është se dashuria e përbashkët duhet të shprehet në shërbesë të përlur. Kështu në disa kultura mund të pastrojmë këpucët e njëri tjetrit. Ne e kemi të qartë se qëllimi i një “kthimi kulturor” të tillë nuk është që të shmangim bindjen, por që ta bëjmë atë bashkëkohore dhe të vërtetë.

Pyetja kontroversiale e statusit të gruas nuk u debatua në Konsultimin tonë. Por ne e njohim nevojën për të kërkuar një kuptim i cili mundohet me integritet të bëjë drejtësi ndaj gjithë mësimëve biblike, dhe i cili shikon marrdhëniet midis burrave dhe grave si të rrënjosura në të njëjtën kohë në rregullin e krijuar dhe i ndryshuar mrekullisht nga rregulli i ri të cilin e solli Jezusi.

E. Puna e vazhdueshme e Shpirtit të shenjtë

A do të thotë theksi ynë në të qenit përfundimtar dhe patundur të normativitetit të Shkrimeve që ne mendojmë që Shpirti i Shenjtë tashmë ka pushuar së punuari? Jo, me të vërtetë jo. Por natyra e shërbesës së tij të së mësuarit ka ndryshuar. Ne besojmë që puna e tij e të “frymëzuarit” ka mbaruar, në kuptimin që kanoni i Shkrimeve është mbyllur, por që puna e tij e të “ndiçuarit” vazhdon si në çdo konvertim (p.sh., 2 Kor. 4:6) dhe në jetë e të krishterit dhe të kishës. Kështu që ne duhet të lutemi vazhdimisht që ai të na ndriçojë sytë e zemrave tona që ne të mund të mund të njohim plotësinë e qëllimit të Perëndisë për ne (Efes. 1:17 e vazhd.) dhe të mos jemi të turpshëm por të guximshëm në marrjen e vendimeve dhe duke ndërmarrë detyra të reja sot.

Ne jemi vënë në ditje që eksperiencia e Shpirtit të Shenjtë duke zbuluar aplikimin e të vërtetës së Perëndisë në jetën e personit dhe të kishës është shpesh më pak e gjallë sesa duhet të jetë; ne të gjithë duhet të jemi më të ndjeshëm në këtë pikë.

Pyetje për diskutim

1. Urdhërimet e Zanafillës 1:26-28 disa herë quhen “mandati kulturor” të cilin Perëndia I dha njerëzimit. Me sa përgjegjësi po përmbushet ai sot?
2. Nën dritën e përkufizimit të kulturës në Seksionin 2, cilat janë elementët kryesorë që janë të ndryshëm në kulturën tuaj?

3. Nëse dini dy gjuhë, bëni një fjali në njërën dhe pastaj përpiquni të gjeni përkthimin “ekuivalent dinamik” të tij në gjuhën tjetër.

4. Jepni shembuj të tjerë të “transpozimit kulturor” (shiko 3d), të cilat ruajnë “kuptimin e brendshëm” të tekstit biblik por e transferojnë atë në kulturën tuaj.

4. Të kuptuarit e Fjalës së Perëndisë Sot

Faktori kulturor është i pranishëm jo vetëm në vetë-zbulesën e Perëndisë në Shkrimet, por gjithashtu edhe në interpretimin tonë të tyre. Këtij subjekti i kthehemi tani. Të gjithë të krishterët janë të interesuar për të kuptuar Fjalën e Perëndisë, por ka mënyra të ndryshme për të bërë këtë.

A. Mënyra Tradicionale

Mënyra më e zakonshme është të vish drejt tek fjalët e tekstit biblik, dhe ti studiosh ato pa ndonjë njohuri që konteksti kulturor i shkrimtarit është ndryshe nga ai i lexuesit. Lexuesi e interpreton tekstin sikur të ishte shkruar në gjuhën, kulturën dhe kohën e tij.

Ne pohojmë se shumë nga Shkrimet mund të lexohet dhe kuptohet në këtë mënyrë, sidomos nëse përkthimi është i mirë. Kjo sepse Perëndia e drejton fjalën e tij për njerëzit e zakonshëm; nuk duhet të trajtohet si krijesa e shkencëtarëve; të vërtetat qëndrore të shpëtimit janë të qarta për tu parë; Shkrimet janë “të dobishme për të mësuar të vërtetën, qortuar gabimin, korrigjuar mungesat, dhe për të dhënë mësim për jetesën e drejtë” (2 Tim. 3:16); dhe Shpirti i Shenjtë është dhënë për të qenë mësuesi jonë.

Dobësia e kësaj mënyre “popullore”, megjithatë është se nuk kërkon fillimisht të kuptojë tekstin në kontekstin e tij fillestar; dhe, si rrjedhim, ka me vete rrezikun e të mos kuptuarit të kuptimit të vërtetë që Perëndia do të japë dhe zëvendësimi me një tjetër.

Një mënyrë e dytë merr seriozitetin e duhur kontekstin historik dhe kulturor fillestar. Kërkon gjithashtu të zbulojë se çfarë kuptimi kishte teksti në gjuhën origjinale, dhe si lidhet me pjesën tjetër të Shkrimeve. E gjitha kjo është një disiplinë themelore sepse Perëndia i foli fjalën e tij një populli të caktuar në një kohë të caktuar. Kështu kuptimi ynë i mesazhit të Perëndisë do të rritet kur të futemi thellë në këto çështje.

Dobësia e kësaj mënyre “historike”, megjithatë, është se dështon të marrë parasysh çfarë mund të jetë duke i thënë Shkrimi lexuesit bashkëkohor. Ndalon theksueshëm të kuptimi i Biblës në kohën dhe kulturën e saj. Në këtë mënyrë është e besueshme të analizosh tekstin pa e aplikuar atë, dhe të përfitosh dituri shkencore pa besnikëri. Interpretuesi mund të mundohet të zmadhojë mundësinë e objektivitetit të plotë dhe të mospërfillë paramendimet kulturore të tij ose të saj.

B. Mënyra Kontekstuale

Një mënyrë e tretë fillon me kombinimin e elementeve pozitive të të dyja mënyrave “popullore” dhe “historike”. Nga “historikja” merr nevojën e së studiuarit të tekstit dhe gjuhës origjinale, dhe nga “popullorja” nevojën e së dëgjuarit të Fjalës së Perëndisë dhe bindjes ndaj saj. Por ecën edhe më tej. Merr parasysh seriozisht kontekstin kulturor të lexuesve bashkëkohorë si dhe atë të tekstit biblik, dhe njeh që duhet të zhvillohet dialog midis këtyre të dyjave.

Është nevoja për këtë lojë dinamike midis tekstit dhe intepretuesve të tij të cilin theksojmë ne. Lexuesit e sotshëm nuk mund të vijnë tek teksti në një vakum personal,

dhe as që nuk duhet të mundohen. Në vend të kësaj, ata duhet të vijnë me një ndjesi që vjen nga sfond kulturor, situatë personale, dhe përgjegjësi ndaj të tjerëve. Këto shqetësime do të influencojnë pyetjet të cilat i ngrihen Shkrimeve. Çfarë merret në kthim, megjithatë, nuk janë vetëm përgjigje, por edhe më shumë pyetje. Kur i drejtohem Shkrimeve, Shkrimet na drejtohen neve. Ne kuptojmë që paramendimet tona të kushtëzuara kulturore sfidohen dhe pyetjet tona korrigjohen. Në fakt, ne nxitemi të riformulojmë pyetjet tona të mëparshme dhe të bëjmë pyetje të reja. Kështu ndërveprimi i gjallë vazhdon.

Në këtë proces ndërveprimi dituria jonë për Perëndinë dhe përgjigjja jonë ndaj vullnetit të tij thellohen vazhdimisht. Sa më shumë ne e njohim atë, aq më e madhe bëhet përgjegjësia jonë për t'iu bindur vullnetit të tij në situatën tonë, dhe sa më shumë që i përgjigjemi bindshëm, aq më shumë ai e zbulon veten e tij.

Është kjo rritje e vazhdueshme në dituri, dashuri dhe bindje që është qëllimi dhe përfitimi i mënyrës “kontekstuale”. Nga konteksti në të cilën fjala e tij është dhënë fillimisht, ne dëgjojmë Perëndinë që na flet ne në kontekstin bashkëkohor, dhe e marrim si një përjetesë transformuese. Ky proces është një spirale e drejtuar për lart në të cilën Shkrimet mbeten gjithmonë qëndrore dhe urdhëruese.

C. Komuniteti që Mëson

Ne duam të theksojmë që detyra e të kuptuarit të Shkrimeve i përket jo vetëm individëve por të gjithë komunitetit të krishterë, e parë si një bashkësi si bashkëkohore ashtu edhe historike.

Ka shumë mënyra nëpërmjet të cilave kisha lokale apo zonore mund të dallojë vullnetin e Perëndisë në kulturën e tij sot. Krishti akoma emëron pastorë dhe mësues në kishën e tij. Dhe në përgjigje të lutjeve pritëse ai i flet njerëzve të tij, sidomos nëpërmjet predikimit të fjalës së tij në kontekstin e adhurimit. Si shtesë, ka vend edhe për “mësimin dhe qortimin e njëri tjetrit” (Kol. 3:16) si në studimet e Biblës në grup dhe në konsultën me kishat motra, ashtu edhe në dëgjimin e qetë të zërit të Perëndisë në Shkrimet, e cila është një element i domosdoshëm në jetën e krishterë të besimtarit.

Kisha është gjithashtu një bashkësi historike dhe ka marrë nga e kaluara një trashëgimi të pasur të teologjisë së krishterë, liturgjisë dhe rritjes shpirtërore. Asnjë grup besimtarësh nuk mund të mospërfillë këtë trashëgimi pa rrezikuar varfërim shpirtëror. Në të njëjtën kohë, kjo traditë nuk duhet të merret pa u shqyrtuar, nëse vjen në formën e një grupimi veçantish denominacionale ose në ndonjë mënyrë tjetër, por duhet të testohet nga Shkrimet që ajo shpall që zgjeron. As nuk duhet të vendoset me forcë mbi ndonjë kishë, por të bëhet e arritshme për ata që mund ta përdorin si material të dobishëm, si një kundërpeshë ndaj shpirtit të pavarësisë, dhe si një lidhje me kishën universale.

Kështu Shpirti i Shenjtë e mëson popullin e tij nëpërmjet një shumëllojshmëri mësuesish si të kaluarës ashtu edhe të së tashmes. Ne kemi nevojë për njëri tjetrin. Është vetëm “me të gjithë të shenjtët” që ne mund të fillojmë të kuptojmë përmasat e plota të dashurisë së Perëndisë (Efes. 3:18,19). Shpirti “ndriçon mendjet e popullit të Perëndisë në çdo kulturë për të kuptuar të vërtetën e saj (do të thotë të Shkrimeve) në çdo kulturë sërisht me sytë e tyre dhe kështu i zbulon të gjithë kishës akoma më shumë nga mençuria shumëngjyrëshe e Perëndisë” (Konventa e Lozanës, para. 2, bazohet te Efes. 3:10).

D. Pjesët e pafolura të Shkrimeve

Ne kemi gjithashtu marrë parasysh problemin e pjesëve të pafolura të Shkrimeve, që do të thotë, ato zona të doktrinës dhe etikës mbi të cilat Bibla nuk ka asgjë të drejtpërdrejtë për të thënë. Të shkruara në botën e vjetër hebraike dhe greko-romake, Shkrimet nuk i drejtohen drejtpërdrejt përshembull, hinduizmit, budizmit, ose islamizmit sot, ose teorive marksiste social-ekonomike, ose teknologjisë bashkëkohore. Megjithatë, ne besojmë që është e drejtë që kisha të drejtohet nga Shpirti i Shenjtë për të hulumtuar Shkrimet për gjëra të parandodhura dhe parime të cilat do ta mundësojnë atë të zhvillojë mendje si të Zotit Krisht dhe kështu të bëhet e aftë të marrë vendime të vërteta të krishtera. Procesi do të vazhdojë më me sukses brenda bashkësisë besimtare ndërsa adhuron Perëndinë dhe përfshihet në besnikëri aktive në botë. Përsërisim që bindja e krishterë është sa një hyrje në të kuptuar atë edhe një rrjedhojë e saj.

Pyetje për diskutim

1. A mund të kujtoni shembuj se si njëra ose tjetra mënyrë "tradicionale" e leximit të Biblës ju kanë çuar në rrugë të gabuar?
2. Zgjidhni një tekst të mirënjohur si Mateu 6:24-34 (shqetësimi ose ambicia) ose Luka 10:25-38 (Samaritani i mirë dhe përdorni "mënyrën kontekstuale" për ta studiuar atë. Lejoni të zhvillohet një dialog midis juve dhe tekstit, ndërsa ju e hulumtoni atë dhe ai ju hulumton juve. Mbani shënime mbi shkallët e ndërveprimit tuaj.
3. Lexoni seksionet 3e dhe 4c, dhe pastaj diskutoni mënyra praktike për kërkimin e drejtimit të Shpirtit të Shenjtë sot.

5. Përmbajtja dhe Komunikimi i Ungjillit

Duke paur menduar rreth komunikimit të Perëndisë të ungjillit ndaj nesh në Shkrimet, tani vijmë në zemër të problemit tonë, përgjegjësinë tonë për ta komunikuar atë te të tjerët, domethënë, për të ungjillizuar. Por përpara se të konsiderojmë komunikimin e ungjillit, ne duhet të konsiderojmë përmbajtjen e ungjillit i cili do të komunikohet. Sepse "të ungjillizosh është të përhapësh lajmin e mirë--" (Konventa e Lozanës, para. 4). Atëherë nuk ka ungjillizim pa ungjillin.

A. Bibla dhe Ungjilli

Ungjilli duhet të gjendet në Bibël. Në fakt, në një mënyrë e gjithë Bibla është ungjill, nga Zanafilla te Zbulesa. Kjo sepse qëllimi kryesor i saj është nga fillimi në fund të dëshmojë për Krishtin, për të shpallur lajmin e mirë që ai është jetëdhënësi dhe Zoti, dhe të bindë njerëzit të besojnë te ai (p.sh. Gjoni 5:39, 40; 20:31; 2 Tim. 3:15).

Bibla e shpall historinë e ungjillit në shumë forma. Ungjilli është si një diamant me shumë faqe, me aspekte të ndryshme që tërheqin njerëz të ndryshëm në kultura të ndryshme. Ka thellësi që ne nuk i kuptojmë dot. Hedh poshtë çdo provë për ta reduktuar atë në një përkufizim të thjeshtë.

B. Zemra e Ungjillit

Megjithatë, është e rëndësishme të identifikojmë çfarë është në zemër të ungjillit. Ne njohim si qendrore temat e Perëndisë si Krijues, universaliteti i mëkatit, Jezus Krishti si Biri i Perëndisë, Zot i gjithçkaje, dhe Shpëtimtar nëpërmjet vdekjes së tij shpenguese dhe jetës së ringjallur, nevojën për konvertim, ardhjen e Shpirtit të Shenjtë dhe fuqinë e tij ndyshuese, bashkësinë dhe misionin e Kishës së krishterë, dhe shpresën e kthimit të Krishtit.

Ndërsa këto janë të gjithë elementë themelorë të ungjillit, është e nevojshme të shtojmë që asnjë deklaram teologjik nuk është i paprekshëm nga kultura. Atëherë, të gjitha formulimet teologjike duhet të gjykohen nga vetë Bibla, që qëndron mbi të gjitha ato. Vlera e tyre duhet të gjykohet nga besnikëria e tyre ndaj saj si dhe nga rëndësia me të cilën ata e aplikojnë mesazhin në kulturën e tyre.

Me dëshirën tonë për të komunikuar ungjillin në mënyrë efektive, ne shpesh vihemi në dijeni për ato elementë në të që njerëzit nuk pëlqejnë. Për shembull, kryqi ka qenë gjithmonë si një fyerje ndaj krenarëve ashtu edhe një çmënduri për të mençurit. Por Pali nuk e hoqi nga mesazhi i tij në bazë të këtyre të dhënave. Në të kundërt, ai vazhdoi ta shpallë atë, me besnikëri madje me rrezikun e përndjekjes, me besim që Krishti i kryqëzuar është mençuria dhe fuqia e Perëndisë. Ne gjithashtu, megjithëse të shqetësuar për të vënë në kontekstin e duhur dhe për ta hequr nga çdo sulm i panevojshëm, duher ti rezistojmë çdo tundimi për ti dhënë vend krenarisë njerëzore ose paragjyqimeve. Na është dhënë neve. Pëgjegjësia jonë është jo ta korrigjojmë por ta shpallim atë.

C. Barrierat Kulturore Ndaj Komunikimit Të Ungjillit

Asnjë dëshmitar i krishterë nuk mund të shpresojë të komunikojë ungjillin nëse ai ose ajo nuk merr parasysh faktorin kulturor. Kjo është veçanërisht e vërtetë në rastin e misionarëve. Kjo sepse ata janë vetë produkt i një kulture dhe shkojnë tek njerëz që janë produkt i një tjetre. Kështu si rrjedhim ata janë të përfshirë në komunikimin ndër-kulturor, me të gjithë sfidën e saj ngazëllyese dhe kërkesat e saj të mëdha. Dy probleme të mëdha i dalin përpara.

Disa herë njerëzit i rezistojnë ungjillit jo se mendojnë se është i rremë por sepse ata e marrin si një kërcënim për kulturën e tyre, sidomos për themelin e shoqërisë së tyre, dhe solidaritetit të tyre kombëtar ose fisnor. Deri në një farë mase kjo mund të evitohet. Jezus Krishti ishte një shqetësues aq sa ishte paqësor. Ai është Zot, dhe kërkon besnikërinë tonë të plotë. Kështu, disa hebrenj të shekullit të parë e shikonin ungjillin si shkatërrues për themelet e judaizimit dhe e akuzuan Palin që “mësonte njerëzit gjithandej kundër popullit, ligjit dhe këtij vendi,” dmth. Tempullit (Veprat 21:28). Në të njëjtën mënyrë, disa romakë të shekullit të parë frikësoheshin për stabilitetin e shtetit, përdërisa në pikëpamjen e tyre misionarët e krishterë, duke thënë që “ka një mbret tjetër, Jezusi,” i ishin jobesnikë Cezarit dhe mbronin zakone të cilat nuk ishin të ligjshme për romakët të zbatoheshin (Veprat e Ap. 16:21; 17:7). Jezusi akoma sot sfidon shumë nga besimet dhe zakonet e dashura të çdo kulture dhe shoqërie.

Në të njëjtën kohë, ka elemente të çdo kulture të cilat nuk janë të papërputhshme me mjeshtërinë e Krishtit, dhe si rrjedhim atëherë nuk duhet të kërcënohen ose të hidhen poshtë, por madje të ruhen dhe transformohen. Lajmëtarët e ungjillit duhet të zhvillojnë një kuptim të thellë të kulturës vendore, dhe një vlerësim i vërtetë për të. Vetëm atëherë kur ata janë të aftë të kuptojnë nëse qëndresa është për disa sfidë e pashmangshme e

Jezus Krishtit ose për disa kërcënim për kulturën për të cilën, nëse imagjinare ose e vërtetë, nuk është e vërtetë.

Problemi tjetër është që ungjilli shpeshherë i paraqitet njerëzve në forma kulturore të huaja. Më vonë misionarët fajësohen dhe mesazhi i tyre hidhet poshtë sepse puna e tyre nuk shihet si ungjillizim por si një provë për të vendosur me dhunë zakonet dhe mëyrën e tyre të jetesës. Kur misionarët sjellin me vete mënyrat e tyre të huaja të sjelljes, ose sjelljetë racës superiore, atërisë, ose shqetësimi për gjëra materiale, komunikimi efektiv do të pritët.

Disa herë këto dy gabime kulturore janë të bashkuar bashkë, dhe lajmëtarët e ungjillit janë fajtorë për imperializëm kulturor i cili siç shkatërron pa nevojë kulturën vendase ashtu edhe kërkon të vendosë me dhunë në vend të saj një kulturë të huaj. Disa nga misionarët që shoqëronin *conquistadores* katolikë të Amerikës Latine dhe kolonizatorët protestantëtë Afrikës dhe Azisë janë shembuj historikë të një gabimi të dyfishtë. Si kontrast, apostulli Pal mbetet shembulli më i madh i të cilit Jezus Krishti fillimisht e zhveshi nga krenaria e privilegjeve të tij kulturore (Fil. 3:4-9) dhe më vonë e mësoi si ti përshtatej kulturave të të tjerëve, duke e bërë veten skllav dhe duke u bërë “gjithçka të gjithëve” në mënyrë që me çdo mjet të shpëtojë disa (1 Kor. 9:19-23).

D. Ndjeshmëria Kulturore në Komunikimin e Ungjillit

Dëshmimi i ndjeshëm ndër-kulturor nuk do të arrijë dot në sferën e tyre të shërbimit me një ungjill të para-paketuar. Ata duhet të kenë një kuptim të qartë të së vërtetës së “dhënë” të ungjillit. Por ata do të dështojnë së komunikuari ungjillin me sukses nëse do të përpiqen ta vendosin me dhunë atë mbi njerëzit pa dalluar gjendjen e tyre kulturore dhe atë të njerëzve të cilët shkojnë. Është vetëm nëpërmjet ndërveprimit aktiv, të dashur me njerëzit vendas, duke menduar në kuadrin e tyre mendor, së kuptuarit të botëkuptimit të tyre, duke dëgjuar pyetjet e tyre, dhe duke pasur ndjesi për barrat e tyre, që e gjithë bashkësia besimtare (ndaj të cilës ajo misionare bën pjesë) do të jetë e aftë për t’iu përgjigjur nevojave të tyre. Me lutje të përbashkët, mendim dhe kërkim në vetvete, në varjen nga Shpirti i Shenjtë, besimtarë vendas dhe të zhvendosur mund të mësojnë së bashku si të shpallin Krishtin dhe ta kontekstualizojnë ungjillin me një shkallë të duhur besnikërie dhe rëndësie. Ne nuk themi që do të jetë e lehtë, megjithëse disa kultura të botës së tretë kanë një përafërsi natyrore me kulturën biblike. Ne besojmë që kuptime krijuese të reja do të ngrihen kur bashkësia besimtare e udhëhequr nga Shpirti dëgjon dhe reagon me ndjeshmëri ndaj vërtetësisë së Shkrimeve dhe nevojave të botës.

E. Dëshmia e Krishterë në Botën Islamike

Shqetësim u shpreh që nuk i është dhënë vëmendje e duhur në Konsultën tonë problemeve të misionit të krishterë në botën islamike, megjithëse ka rreth 600 milion muslimanë sot. Në një anë, një rritje e besimit dhe misionit islam po ndodh në shumë vende; në anën tjetër, ka një hapje drejt ungjillit në një numër bashkësish të cilat po i dobësojnë lidhjet e tyre me kulturën tradicionale muslimane.

Ka nevojë për njohur veçantitë e islamizmit të cilat hapin një mundësi të veçantë për dëshmimin e krishterë. Megjithëse ka elementë në islamizëm që nuk përputhen me ungjillin, ka gjithashtu edhe elemente me një masë të asaj që quhet “konvertibilitet”. Për shembull, kuptimi ynë i krishterë i Perëndisë, i shprehur në thirrjen e madhe të Luterit lidhur me justifikimin, “Le të jetë Perëndia Perëndi”, mund të shërbejë si një përkufizim

inkluziv i muslimanizmit. Besimi musliman në unitetin hyjnor, theksi në detyrimin e njeriut për ti dhënë Perëndisë adhurimin e duhur, dhe hedhja poshtë pa kushte e idhujtarisë mund të konsiderohen si në të njëjtën vijë me qëllimin e Perëndisë për jetën njerëzore e zbuluar në Jezus Krishtin. Dëshmimi bashkëkohor i krishterë duhet të mësojë me përlësi dhe të identifikojë dukshëm, të vlerësojë dhe ndriçojë këto dhe vlera të tjera. Ata gjithashtu duhet të përpiqen për transformimin—dhe, ku ka mundësi, integrim—të gjithçkaje që është e rëndësishme në adhurimin, lutjen, agjërimin, artin, arkitekturën dhe kaligrafinë muslimane.

E gjithë kjo rrjedh vetëm nga një vlerësim i vërtetë i situatës së tanishme të vendeve muslimane të karakterizuara nga zhvillimi teknologjik dhe sekularizimi. Vlerat sociale të pasurisë së re dhe varfërisë tradicionale, tensionet e pavarësisë politike, dhe shpërndarja dhe vuajtja tragjike palestineze—të gjitha këto lejojnë dëshmim të mjaftueshëm të krishterë. Kjo e fundit ka nxjerrë në jetë shumë poezi shpirtërore, një shënim në të cilin mund të gjendet krahasim me vuajtjet e Jezusit. Këto dhe elementë të tjerë thërrasin për një ndjeshmëri të re të krishterë dhe një njohuri të vërtetë të zakoneve introverte për të cilat kisha ka punuar shumë në Lindjen e Mesme. Në vende të tjera, jo më pak në Afrikën nën Sahara, qëndrimet janë më elastike dhe mundësitë më të rrjedhshme.

Për të përmbushur më mirë sfidën misionare, nevojiten përpjekje të reja për zhvillimin e rrugëve të lidhjes së besimtarëve dhe atyre që kërkojnë, nëse e kërkon nevoja jashtë metodave tradicionale të kishës. Thelbi i një sensi përgjegjësie të gjallë, ungjillizimi ndaj muslimanëve do të jetë gjithmonë cilësia e dishepullizimit personal dhe i përbashkët i krishterë dhe dashuria ruajtëse e Krishtit.

F. Në Pritje Të Rezultateve

Lajmëtarët e ungjillit që e kanë vërtetuar në eksperiencën e tyre që është “fuqia e Perëndisë për shpëtimin” (Rom. 1:16) me të drejtë presin që të jetë e vërtetë edhe në eksperiencën e të tjerëve gjithashtu. Ne rrëfejme që disa herë, ashtu siç besimi i centurionit pagan turpëroi mosbesimin e Izraelit në ditët e Jezusit (Mat. 8:10), kështu edhe sot shkalla e besimit të krishterëve në kultura të tjera tregon veten mbi mungesën e besimit të misionarëve. Ne kujtojmë veten pra, për premtimet e Perëndisë nëpërmjet pasardhësve të Abrahamit për bekimin e gjithë familjeve të tokës dhe nëpërmjet ungjillit për të shpëtuar ata që besojnë (Zan. 12:1-4; 1 Kor. 1:21). Është në bazë të këtyre dhe të tjera premtimeve që ne i kujtojmë të gjithë lajmëtarëve të ungjillit, duke përfshirë edhe veten tonë, të kthejnë sytë nga Perëndia për të shpëtuar njerëz dhe për të ndërtuar kishën e tij.

Në të njëjtën kohë, ne nuk harrojmë paralajmërimet e Zotit tonë për kundërshtimin dhe vuajtjen. Zemrat njerëzore janë të forta. Njerëzit nuk e përqafojnë gjithmonë ungjillin, edhe kur komunikimi është pa gabime në teknikë dhe komunikuesi në karakter. Zoti ynë vetë ishte në kulturën ku kishte lindur dhe aty predikonte, megjithatë ai dhe mesazhi i tij u nënvlerësua dhe u hodh poshtë, dhe shëmbëlltyra e tij e mbjellësit duket sikur paralajmëron që shumica e farës së mirë nuk do të sjellë fryt. Ka një mister këtu që nuk mund ta kuptojmë. “Shpirti fryn ku të dojë” (Gjoni 3:8). Në përpjekje për të komunikuar ungjillin me kujdes, besnikëri dhe zell, ne ja lëmë në përujle përfundimin Perëndisë.

Pyetje për Diskutim

1. Në Seksionin 5 a dhe b Raporti kundërshton dhënien e një “përkufizimi të thjeshtë” të ungjillit, por identifikon “zembrën” e tij. A do të donit ti shtonit këtyre “temave qëndrore”, ose të hiqni, apo ti plotësonit?
2. Sqaroni “dy gabimet kulturore” të 5c. A mund të jepni shembuj? Si mund të mënjanoen gabime të tilla?
3. Mendoni për situatën kulturore të njerëzve që ju doni të fitoni për Krishtin. Çfarë do të thotë “ndjeshmëria kulturore” në rastin tuaj?

6. Kërkohen: Lajmëtarë të përlurur të Ungjillit!

Ne besojmë që kyçi kryesor për komunikim bindës të krishterë gjendet të komunikuesit vetë dhe te çfarë lloj njerëzish janë ata. As që nuk duhet përmendur që ata duhet të jenë njerëz me besim, dashuri të krishterë dhe shenjtëri. Kjo do të thotë që ata të kenë një përjetim personal dhe në rritje të fuqisë ndryshuese të Shpirtit të Shenjtë, në mënyrë që figura e Jezus Krishtit të shihet edhe më qartë në karakterin dhe sjelljen e tyre.

Mbi gjithçka ne dëshirojmë të shikojmë në ta, dhe veçanërisht në ne, “përlulësinë dhe butësinë e Krishtit” (2 Kor. 10:1), me fjalë të tjera, ndjeshmërinë e përlurur të dashurisë së Krishtit. Aq të rëndësishme e mendojmë këtë të jetë sa që po i kushtojmë të tërin këtë seksion të Raportit tonë atij. Për më tepër, përderisa nuk kemi qëllimin të tregojmë me gisht asnjë përveç vetes tonë, do të përdorim vetën e parë shumës gjatë gjithë kësaj pjese. Së pari, ne japim një analizë të përlulësisë së krishterë në situatën misionare, dhe së dyti, kthehemi te mishërimi i Perëndisë në Jezus Krishtin si model që me anë të hirit të dij duam të ndjekim.

A. Një Analizë e Përlulësisë Misionare

Së pari, është përlulësia e njohjes së problemit të cilin kultura sjell, dhe jo ta shmangim apo ta thjeshtojmë atë jashtë mase. Siç kemi parë, kultura të ndryshme kanë influencuar shumë zbulesën biblike, neve dhe njerëzit te të cilët shkojmë. Si rezultat, kemi disa kufizime personale në komunikimin e ungjillit. Ne jemi të burgosur (me ndërgjegje apo jo) të kulturës tonë, dhe kuptimi ynë i kulturave si të Biblës ashtu edhe të vendit në të cilin shërbejmë është shumë i papërsosur. Është ndërveprimi midis gjithë këtyre kulturave që përbën problemin e komunikimit; i përlurur të gjithë ata që merren me të.

Së dyti, është përlulësia që të përpiqesh aq sa të kuptosh dhe vlerësosh kulturën e atyre ku ne shkojmë. Është kjo dëshirë e cila udhëheq në mënyrë të natyrshme në atë dialogun e vërtetë “qëllimi i së cilit është të dëgjojë me ndjeshmëri në mënyrë që të kuptojë” (Konventa e Lozanës, para. 4). Ne pendohe mi për paditurinë që thjesht e merr si fakt që ne i kemi të gjitha përgjigjet dhe që roli ynë i vetëm është të mësojmë të tjerët. Ne kemi shumë për të mësuar. Ne pendohe mi gjithashtu për qëndrimin tonë gjykues. E dimë që kurrë nuk duhet të dënojmë ose urrejmë një kulturë tjetër, por për kundrazi ta respektojmë atë. Ne nuk mbrojmë as arrogancën e cila vendos me forcë kulturën tonë mbi të tjerët, por as sinkretizmin i cili përziën ungjillin me elementët kulturorë të papërputhshëm me të, por përkundrazi një ndarje të përlurur të lajmit të mirë—e bërë e mundur nga respekti i përbashkët i një miqësie të vërtetë.

Së treti, është përlësia për të filluar komunikimin tonë aty ku njerëzit janë dhe nuk janë aty ku duam ne. Këtë shikojmë që bën Jezusi, dhe ne duam të ndjekim shembullin e tij. Shumë shpesh ne kemi injoruar frikat dhe shqetësimet e njerëzve dhimbjet dhe hallet e tyre, dhe urinë, varfërinë, shkatërrimin dhe shtypjen e tyre, në fakt “nevojat e ndjera” të tyre, dhe kemi qenë të ngadaltë të gëzojmë ose qajmë me ta. Ne pohojmë këto “nevoja të ndjera” mund të jenë disa herë simptoma nevojash më të thella të cilat nuk ndjehen ose njihen menjëherë nga njerëzit. Doktorit nuk e pranon padyshim vetë-diagnozën e pacientit. Megjithatë, ne shohim nevojën të fillojmë aty ku janë njerëzit, por jo të ndalojmë aty. Pranojmë përgjegjësinë tonë për ti udhëhequr me butësi dhe durim që të shikojnë vetveten, siç e shikojmë ne veten, si rebelë për të cilët ungjilli flet drejtpërdrejt me një mesazh falje dhe shprese. Të fillosh aty ku janë njerëzit nuk është të ndash një mesazh të parëndësishëm; të qëndrosh aty ku janë njerëzit dhe të mos ti udhëheqësh kurrë tek plotësia e lajmit të mirë të Perëndisë, është të ndash një ungjill të gjymtuar. Ndjeshmëria e përlulur e dashurisë do të mënjanojë të dy gabimet.

Së katërti, është përlësia e së njohurit që edhe misionari më i talentuar, përkushtuar dhe me eksperiencë mundet shumë rrallë të komunikojë ungjillin në një gjuhë tjetër ose kulturë aq me efektivitet sa një i krishterë vendas i stërvitur. Ky fakt është pohuar në këto vite nga Bible Societies, politika e të cilëve ka ndryshuar nga botimi i përkthimeve nga misionarët (me ndihmën e vendasve) te edukimi i specialistëve që përkthejnë në gjuhën e nënës. Vetëm të krishterët vendas mund ti japin përgjigje pyetjeve, “Perëndi, si do ta thojë ti këtë në gjuhën tonë?” dhe “Perëndi, çfarë do të thotë bindje ndaj teje në gjuhën tonë?” Atëherë, nëse jemi duke përkthyer Biblën apo komunikuar ungjillin, të krishterët vendas janë të domosdoshëm. Janë ata që duhet të marrin përsipër të kontekstualizojnë ungjillin në gjuhët dhe kulturat e tyre. Dëshmuesit pretendues ndër-kulturorë nuk janë me çdo kusht sipërfaqësorë; por ne do të jemi të mirëpritur vetëm nëse jemi aq të përlulur sa të shohim komunikimin e mirë si një përpjekje grupi, në të cilën të gjithë besimtarët bashkëpunojnë si partnerë.

Së pesti, është përlësia për të besuar në Shpirtin e Shenjtë të Perëndisë, i cili është gjithmonë komunikuesi kryesor, i cili vetë hap sytë e të verbërve dhe i sjell njerëzit në lindje të re. “Pa dëshmimin e tij, i joni është pa rezultat” (Konventa e Lozanës, para. 14)

B. Mishërimi si Model për Dëshmimin e Krishterë

U takuam për Konsultimin tonë pak ditë para Krishtlindjeve, që mund të quhet rangi më i veçantë i identifikimit kulturor në historinë e njerëzimit, meqenëse me Mishërimin Biri u bë një izraelit Galileas i shekullit të parë.

Ne kemi kujtuar gjithashtu që Jezusi e do misionin e popullit të tij në botë të jetë i bazuar në të tijn. “Si më dërgoi Ati mua, kështu ju dërgoj unë juve”, tha ai (Gjoni 20:21; af. 17:18). Kemi pyetur veten, atëherë, për rrjedhimet e Mishërimit për të gjithë ne. Pyetja ka rëndësi të veçantë për ata që dëshmojnë ndër-kultura, në çfarëdo vendi që shkojnë, megjithëse ne kemi menduar veçanërisht për ata nga perëndimi që kanë shërbyer në botën e tretë.

Duke medituar mbi Filipianët 2, ne kemi parë që vetë-përlulja e Krishtit filloi në mendjen e tij: “ai nuk e mbajti njësinë me Perëndinë një gjë për tu fituar”. Ne jemi urdhëruar të lëmë mendjen e tij të jetë në ne, dhe në përlulësinë e mendjes të “mendojmë” të tjerër më të mirë apo më të mirë se veten tonë. Kjo “mendje” apo “perspektivë” e Krishtit është një pohim i vlerës së pafundme të qenieve njerëzore dhe të privilegjit që kemi ti

shërbejmë atyre. Ata dëshmitarë që kanë mendjen e Krishtit do të kenë një respekt të thellë për njerëzit që shërbejnë, dhe për kulturat e tyre.

Dy folje, pra tregojnë veprimin të cili mendja e Krishtit e udhëhoqi atë: “ai e zbrazi veten e tij...e përuli veten e tij...” I pari flet për sakrificën (atë që ai hodhi poshtë) dhe i dyti për shërbim, deri në skllavëri (si u identifikua ai vetë me ne dhe vendosi veten në shërbimin tonë). Menduam se çfarë do të thonin këto dy veprime për të, dhe çfarë do të thonë për dëshmimin ndër-kulturor.

Fillojmë me *dorëzimin* e tij. Së pari, dorëzimi i statusit. “Me butësi e la mënjanë lavdinë e tij”, kemi kënduar për krishtlindje. Për arsye se nuk mund ta konceptojmë dot se si është lavdia e tij, është e pamundur të kuptojmë madhështinë e vetë-zbrazjes së tij. Por me siguri ai i dorëzoi të drejtat, privilegjet dhe fuqitë që zotëronte si Bir i Perëdisë. “Statusi” dhe “simbolet e statusit” kanë shumë rëndësi në botën e sotme, por janë të papërputhshme të misionarët. Ne besojmë që kudo që janë, misionarët nuk duhet të jenë në kontroll apo të punojnë vetëm, por gjithmonë me—dhe mundësisht nën—të krishterë vendas të cilët mund ti këshillojnë dhe madje ti udhëheqin. Dhe cilado që të jetë përgjegjësia e misionarëve ndoshta ata duhet të tregojë qëndrime “jo dominimi por shërbimi” (Konventa e Lozanës, para. 11).

Tjetër është dorëzimi i pavarësisë. Kemi parë Jezusin—duke i kërkuar një gruajë samaritane ujë, duke jetuar në shtëpitë e të tjerëve dhe me paratë e të tjerëve sepse nuk kishte të vetat, duke iu dhënë borxh një varkë, një gomar, një dhomë e sipërme dhe edhe duke u varrosur në një varr të dhënë borxh. Në të njëjtën mënyrë, lajmëtarët ndër-kulturorë, sidomos në vitet e tyre të para të shërbimit, duhet të mësojnë vartësinë nga të tjerët.

Së treti, dorëzimi i paprekshmërisë. Jezusi e zbuloi veten ndaj tundimit, vajtimit, kufizimit, nevojës ekonomike dhe vuajtjes. Kështu edhe misionari duhet të presë që të bëhet i prekshëm nga tundime të reja, rreziqe dhe sëmundje, një klimë të çuditshme, një vetmie të papritur dhe ndoshta edhe vdekja.

Duke u kthyer nga tema e dorëzimit të ajo e *identifikimit*, ne jemi mahnitur sërish me plotësinë e identifikimit të Shpëtimtarit tonë me ne, sidomos siç mësohet te Letra drejtuar Hebrejve. Ai ndau në “mishin dhe gjakun” tonë, u tundua siç tundohemi ne, mësoi të bindej nëpërmjet vuajtjeve dhe provoi vdekjen për ne (Heb. 2:14-18; 4:15; 5:8). Gjatë shërbesës së tij publike Jezusi bëri miq të tij të varfërit dhe të pafuqishmit, shëroi të sëmurët, ushqeui të uriturit, preku të paprekshmit, dhe rrezikoi emrin e tij duke u shoqëruar me ata që shoqëria i hidhte poshtë.

Mënyra deri ku ne e identifikojmë veten tonë me njerëzit të cilët shkojmë është një çështje e vështirë. Sigurisht që duhet të përfshijë të mësuarit të gjuhës së tyre, zhytjen e vetes tonë në kulturën e tyre, të mësuarit të mendojmë si ata, të ndjejmë si ata ndjejmë, të bëjmë si ata bëjnë. Në nivelin social-ekonomik ne nuk besojmë se duhet “të kthehemi në natyrë”, së pari sepse përpjekja e një të huaji të bëjë këtë mund të shihet jo si e vërtetë, por si lojë. Por gjithashtu nuk mendojmë se duhet të ketë një pabarazi të dukshme midis mënyrës sonë të jetesës dhe atë të njerëzve rreth e rrotull nesh. Midis ekstremeve, shohim mundësinë e zhvillimit të një standarti jetese i cili shpreh llojin e dashurisë e cila kujdeset dhe ndan, dhe e cila e sheh normale të shkëmbejë mikpritje me të tjerët në bazë të reciprocitetit, pa u turpëruar. Një test kërkimor i identifikimit është sa shumë ndjehemi pjesë e njerëzve, dhe—akoma më shumë—sa ata na përkasin neve. A marrim pjesë natyrshëm në ditët kombëtare apo fisnore të falenderimit apo

vajtimit? A rënkojmë ne me ta në shtypjen nën të cilën vuajnë dhe i bashkohemi atyre në kërkim të drejtësisë dhe lirisë? Nëse vendi goditet nga tërmete apo futet në luftë civile, a është instinkti ynë të qëndrojmë dhe vuajmë ma njerëzit që duam, apo të ikim me avion në shtëpi?

Megjithëse Jezusi e identifikoi veten e tij plotësisht me ne, ai nuk e humbi identitetin e tij. Ai mbeti vetvetja. “Ai erdhi nga qielli...dhe u bë njeri” (Kredo e Nicës); megjithatë në bërjen një nga ne i nuk pushoi së qeni Perëndi. Në të njëjtën mënyrë, “ungjilltarët e Krishtit duhet përlshëm të kërkojë të zbrazin veten e tyre nga gjithçka përveç veçantisë së tyre personale” (Konventa e Lozanës, para. 10). Mishërimi na mëson identifikim pa humbje identiteti. Besojmë se vetë-sakrifikim i vërtetë çon në vetë-zbulim të vërtetë. Në shërbesë të përlur ka gëzim të madh.

Pyetje për diskutim

1. Nëse çelësi për komunikim gjendet te komunikuesit, çfarë lloj njerëzish duhet të jenë ata?
2. Jepni analizën tuaj të përljes që të gjithë dëshmitarët e krishterë duhet të kenë. Ku do ta vinit theksin?
3. Përderisa Mishërimi përfshinte si “dorëzim” ashtu edhe “identifikim”, ishte siç duket shumë e kushtueshme për Jezusin. Cila do të ishte kostoja e “ungjillimit mishërues” sot?

7. Konvertimi dhe Kultura

Kemi menduar për marrdhëniet midis konvertimit dhe kulturës në dy mënyra. Së pari, çfarë efekti ka konvertimi në situatën kulturore të të konvertuarve, mënyrat në të cilat ata mendojnë dhe veprojnë, dhe qëndrimet e tyre ndaj ambjentit të tyre shoqëror? Së dyti, çfarë efekti ka patur kultura jonë në kuptimin tonë të konvertimit? Të dy pyetjet janë të rëndësishme. Por duam të themi menjëherë se elementët në pikëpamjen tonë ungjillore tradicionale janë më shumë kulturorë sesa biblikë, dhe duhet të sfidohen. Shumë shpesh kemi menduar për konvertimin so një krizë, në vend të një procesi gjithashtu; ose e kemi parë konvertimin gjërësisht si një përjetim personal, duke harruar përgjegjësitë e tij vijuese publike dhe shoqërore.

A. Natyra Radikale e Konvertimit

Jemi të bindur se natyra radikale e konvertimit të Jezus Krishtit duhet të pohohet në kishën bashkëkohore. Kjo sepse ne jemi gjithmonë në rrezik që ta kthejmë në tallje, sikur të mos ishte asgjë tjetër përveçse një ndryshim sipërfaqësor, dhe një vetë-reformim në të. Por autorët e Dhjatës së Re shkruajnë për të si një shprehje e jashtme e një ripërtëritje ose një lindje e re nga Shpirti i Perëndisë, një rikrijim, dhe ringjallje nga vdekja shpirtërore. Koncepti i ringjalljes duket të jetë veçanërisht i rëndësishëm. Ringjallja e Jezus Krishtit nga të vdekurit ishte fillimi i krijimit të ri të Perëndisë, dhe nga hiri i Perëndisë nëpërmjet bashkimit me Krishtin ne kemi ndarë në ringjalljen e tij. Ne kemi hyrë në një erë të re dhe kemi provuar tashmë fuqitë dhe gëzimet e saj. Kjo është përmasa eskatologjike e konvertimit të krishterë. Konvertimi është një pjesë integrale e Ripërtëritjes së Madhe të cilën Perëndia ka filluar, dhe e cila do të sillet në një plotësim triumfal kur Krishti do të vijë në lavdinë e tij.

Konvertimi përfshin gjithashtu një lënije të së kaluarës aq plotësisht që flitet në termat e vdekjes. Ne jemi kryqëzuar me Krishtin. Nëpërmjet kryqit të tij ne kemi vdekur ndaj botës pagane, pikëpamjes së saj, dhe standarteve të saj. Ne kemi gjithashtu “hequr” si një veshje e vjetër Adamin e vjetër, njerëzimin tonë të kaluar të rënë. Dhe Jezusi na paralajmëroi ne që kjo lënije mënjanë e të kaluarës mund të përfshijë sakrifica të dhimbshme, dhe madje edhe humbjen e familjes dhe pasurive (p.sh., Lk. 14:25 e mtj.). Është shumë e rëndësishme të mbajmë së bashku këto aspekte pozitive dhe negative të konvertimit, heqjen mënjanë të së vjetrës dhe veshjen e së resë. Ne që vdiqëm jemi të gjallë përsëri, por të gjallë tani me një jetë të re të jetuar për, në dhe nën Krishtin.

B. Zotëria e Jezus Krishtit

Jemi të qartë që kuptimi kryesor i konvertimit është ndryshim i bindjes. Perëndi dhe zotër të tjerë—idhujtari që të gjithë—zotëronin më përpara mbi ne. Por tani Jezus Krishti është Zot. Parimi zotërues i jetës së konvertuar është që jetohet nën zotërinë e Krishtit ose (sepse vjen te e njëjta gjë) në mbretërinë e Perëndisë. Autoriteti i tij mbi ne është i plotë. Kështu kjo besnikëri e re dhe çliruese udhëheq si pasojë e paevitueshme në një rivlerësim të çdo aspekti të jetëve tona dhe në veçanti të botë-vështrimit tonë, sjelljes tonë dhe marrdhënieve tona.

Së pari, botë-vështrimi ynë. Ne jemi të rënë dakort që zemra e çdo kulture është një “fè” e një lloji, edhe nëse është një fè e pafè si Marksizmi. “Kultura është fèja e bërë e dukshme” (J. H. Bavinck). Dhe “fèja” është një pjesë e tërë e vlerave dhe besimeve kryesore, që është arsyeja pse për qëllimet tona ne po përdorim “botë-vështrimin” si një shprehje e njëjtë. Konvertimi i vërtetë në Krishtin është i lidhur, atëherë, të godasi në zemër të trashëgimisë tonë kulturore. Jezus Krishti ngul këmbë që të heqim nga qendra e botës tonë çfarëdo idhulli që ka qenë duke mbretëtuar më përpara aty, dhe duke zënë fronin për vete. Ky është ndryshimi radikal i besnikërisë që përbën konvertimin, ose të paktën fillimin e tij. Pasi atëherë Krishti ka marrë vendin që i përket atij, çdo gjë fillon të lëvizë. Valët e shokut rrjedhin nga qendra në rreth. I konvertuari duhet të rimendojë besimet e tij ose të saj themelore. Kjo është *metanoia*, “pendesa” e parë si një ndryshim i mendjes, zëvendësimi i “mendjes prej mishi” nga “mendja e Krishtit”. Sigurisht, zhvillimi i një botë-vështrimi të përqendruar të krishterë mund të zgjasi një jetë të tërë, por është aty në esencë nga fillimi. Nëse rritet, pasojat eksplozive nuk mund të parashikohen.

Së dyti, sjellja jonë. Zotëria e Jezusit sfidon standartet tona morale dhe gjithë etikën e mënyrës së jetesës. Duke folur drejt, kjo nuk është “pendesë” por “fryt që përfiton pendesë” (Mateu 3:8), ndryshimi i sjelljes i cili del nga një ndryshim vështrimi. Mendjet dhe vullnetet tona duhet ti përulen besnikërisë së Krishtit (si 2 Kor. 10:5; Mateu 11:29,30; Gjoni 13:13).

Duke dëgjuar studimet e çështjeve të konvertimit ne jemi habitur nga parësia e dashurisë në përjetimin e të konvertuarit të ri. Konvertimi jep si nga kthimi brenda i cili është shumë i preokupuar me veten për tu shqetësuar për të tjerët dhe nga fatalizmi i cili i konsideron të pamundur për ti ndihmuar ata. Konvertimi është i rremë nëse nuk na çliron ne në dashuri.

Së treti, marrdhëniet tona. Megjithëse i konvertuari duhet të bëjë të pamundurën që të mos priset me kombin, fisin dhe familjen, disa herë konflikte të dhimbshme dalin në pah. Është e qartë gjithashtu që konvertimi përfshin një transferim nga njëra bashkësi

në tjetrën, që do të thotë, nga njerëzimi i rënë në njerëzimin e ri të Perëndisë. Ndodhi që në fillim në ditën e rrëshajave: "Shpëtoni veten tuaj nga ky brez i poshtër", thërriti Pjetri. Kështu ata që pranuan këtë mesazh u pagëzuan në shoqërinë e re, e përkushtuan veten e tyre në bashkësinë e re, dhe zbuluan që Zoti i shtonte numrit të tyre çdo ditë (Veprat e Ap. 2:40-47). Në të njëjtën kohë, "transferimi" i tyre nga një grup në tjetrin do të thote më shumë që ata ishin të veçuar shpirtërisht sesa të veçuar shoqërisht. Ata nuk e braktisën botën. Në të kundërt, ata përfituan një besnikëri të re ndaj tij, dhe dolën në botë për ta dëshmuar dhe shërbyer.

Të gjithë ne duhet të gëzohemi në pritje të mëdha të konvertimeve kaq radikale në ditët tona, duke përfshirë të konvertuar në mendje të reja, një mënyrë e re jetese, një bashkësi e re, dhe një mision i ri, gjithçka nën zotërinë e Krishtit. Megjithatë tani ne ndjejmë që duhet të japim disa kualifikime.

C. I Konvertuari dhe Kultura e Tij

Konvertimi nuk duket të "çkulturojë" një të konvertuar. Me të vërtetë, siç kemi parë, Zoti Jezus tani ka besnikërinë e tij ose të saj, dhe gjithçka në kontekstin kulturor duhet të vihet nën hulumtimin e Zotit të tij. Kjo i përshtatet çdo kulture, jo vetëm atyre hindu, budiste, muslimane, ose kulturave të shpirtërave por gjithashtu edhe të kulturës në rritje materialiste të perëndimit. Kritika mund të çojë në përplasje, si elementë të kulturës vijnë nën gjykimin e Krishtit dhe duhet të hidhen poshtë. Në këtë pikë, si kundërsulm, i konvertuari mund të përpiqet të marrë kulturën e ungjillizuesit; kjo përpjekje duhet hedhur poshtë me butësi.

I konvertuari duhet të inkurajohet të shohë marrdhënien e tij ose të saj me të kaluarën si një kombinim i thyerjes dhe vazhdimësisë. Sado që besimtarët e rinj ndajnë nevojën të dorëzohen për hir të Krishtit, ata janë akoma të njëjtët njerëz me të njëjtën trashëgimi dhe të njëjtën familje. "Konvertimi nuk çbën; ribën." Është gjithmonë tragjike, megjithëse në disa situata e pashmangshme, kur konvertimi i një njeriu ndaj Krishtit interpretohet nga të tjerët si tradhëti ndaj origjinës së tij ose saj kulturore. Nëse e mundur, përveç konflikteve të kulturës së tyre, besimtarët e rinj duhet të mundohen të identifikohen me gëzimet, shpresat, dhimbjet dhe shqetësimet e kulturës së tyre.

Studime historike tregojnë që të konvertuarit kalojnë në tre faza: (1) "hedhja poshtë" (kur e shohin veten e tyre si "njerëz të rinj në Krishtin" dhe qortojnë gjithçka që ka të bëjë me të kaluarën e tyre); (2) "lënija e vendit" (kur zbulojnë trashëgiminë e tyre etnike dhe kulturore, me tundimin të kompromentojnë besimin e sapogjetur të krishterë në lidhje me trashëgiminë e tyre); dhe (3) "rivendosja e identitetit" (kur ose hedhja poshtë e së kaluarës ose lënija vend saj mund të rritet, ose më mirë, mund të rriten në një vetënjohje të barazpeshuar të krishterë në Krishtin dhe në kulturën).

D. Takimi i Fuqisë

"Jezusi është Zot" do të thotë më shumë sesa ai është Zot i botë-vështrimit individual të konvertuarit, standarte dhe marrdhënie, dhe më shumë sesa ai është Zot i kulturës. Do të thotë që ai është Zot i fuqive, duke qënë i ngritur lart nga Ati në sovranitetin universal, principatave dhe fuqive që i janë përlur atij (1 Pjetri 3:22). Një numër nga ne, sidomos nga Azia, Afrika dhe Amerika Latine, kanë folur si për realitetin e fuqive të liga dhe nevojës për të treguar mbizotërimin e Jezusit mbi to. Konvertimi përfshin një takim fuqie. Njerëzit i japin besnikërinë Krishtit kur shohin që fuqia e tij tejkalon atë të

magjikes dhe vudusë, mallkimeve dhe bekimeve të shtriganëve, dhe syrin e keq të shpirtrave të ligë, dhe që shpëtimi i tij është një çlirim i vërtetë nga fuqitë e së ligës dhe vdekjes.

Sigurisht, disa pyesin sot nëse një besim në shpirtërat përputhet me kuptimin tonë shkencor modern të universit. Duam të pohojmë, atëherë, kundër mitit mekanistik mbi të cilin botë-kuptimi tipik perëndimor mbështetet, realiteti i inteligjencave demonike të cilat janë sigurisht të shqetësuara, të fshehura dhe të zbuluara, të diskreditojnë Jezus Krishtin dhe të pengojnë njerëzit që ti afrohen atij. E mendojmë jetësore në ungjillizim në të gjitha kulturat të mësojmë realitetin dhe armiqësinë e fuqive demonike, dhe të shpallim që Perëndia e ka ngritur lart Krishtin si Zot i gjithçkaje dhe që Krishti, që me të vërtetë ka të gjithë fuqinë, sado që mund të dështojnë ta njohin këtë, mund (ndërsa e shpallim atë) të thyejmë çdo botë-vështrim në çdo mendje për të shpallur zotërinë e tij dhe të sjellin një ndryshim radikal të zemrës dhe botë-vështrimit.

Duam të theksojmë që fuqia i përket Krishtit. Fuqia në duart njerëzore është gjithmonë e rrezikshme. Kemi rikujtuar temën e përsëritur të Palit në dy letrat e drejtuara Korintasve—që fuqia e Perëndisë, e cila shihet qartë në kryqin e Krishtit, vepron nëpërmjet dobësisë njerëzore (p.sh. 1 Kor. 1:18-2:5; 2 Kor. 4:7; 12:9,10). Njerëzit e botës adhurojnë fuqinë; të krishterët që e kanë i dinë rreziqet e saj. Është më mirë të jesh i dobët, se atëherë ne jemi të fortë. Sidomos nderojmë martirët e krishterë të ditëve të sotme (p.sh. në Afrikën e Lindjes) të cilët e kanë lënë rrugën e fuqisë, dhe kanë ndjekur rrugën e kryqit.

E. Konvertime Individuale dhe Grupi

Konvertimi nuk duhet të mendohet si një eksperiencë e pandryshueshme dhe vetëm individuale, megjithëse ky ka qenë shablloni i pritjes perëndimore për vite të tëra. Në të kundërt, tema e besëlidhjes së Dhjatës së Vjetër dhe pagëzimet shtëpiake të së Resë duhet të na udhëheqin të dëshirojmë, të punojmë për, dhe të presim si nga konvertimet familjare dhe grupore. Shumë kërkime të rëndësishme janë ndërmarrë në vitet e fundit në “lëvizjet popullore” si nga pikëpamjet teologjike ashtu edhe sociale. Në anën teologjike, njohim theksin biblik mbi solidaritetin e secilit *ethnos*, dmth. komb njerëzish. Në anën sociale, njohim që çdo shoqëri përbëhet njga një shumicë nëngrupesh, nënkulturash apo njësi homogjene. Është e dukshme që njerëzit e marrin ungjillin më gatshëm kur i jepet atyre në një mënyrë të duhur—dhe jo të huaj—në kulturën e tyre, dhe kur mund ti përgjigjen me dhe në mes të njerëzve të tyre. Shoqëri të ndryshme kanë procedura të ndryshme për marrjen e vendimeve në grup, p.sh., me konsensus, nga kryetari i familjes, ose nga një grup pleqsh. Njohim vlefshmërinë e dimensionit të përbashkët të konvertimit si një pjesë e procesit të tërë, si dhe nevojën për secilin pjesëtar të grupit përfundimisht të ndajë në të personalisht.

F. A Është Konvertimi i Menjëhershëm apo Gradual?

Konvertimi është shpesh më gradual sesa mësimi tradicional ungjillor ka lejuar. Vërtet, ky mund të jetë vetëm një diskutim fjalësh. Justifikimi dhe rigjenerimi, ai që sjell një status dhe jetë të re, janë punët e Perëndisë dhe të menjëherëshme, megjithëse ne nuk jemi padyshim në dijeni se ku ndodhin. Konvertimi, në anën tjetër, është veprimi ynë (lëvizur nga hiri i Perëndisë) i kthimit të Perëndia në pendesë dhe besim. Megjithëse mund të përfshijë një krizë të ndërgjegjshme, është disa herë e ngadaltë dhe disa herë

e lodhshme. E parë përkundër trashëgimisë së fjalorit Hebre dhe Grek, konvertimi është në thelb një kthim te Perëndia, që vazhdon ndërsa të gjitha pjesët e jetës sillen në rrugë radikale në rritje ndër zotërinë e Krishtit. Konvertimi përfshin ndryshimin e plotë të së krishterit dhe ripërtëritjen e plotë në mendje dhe karakter në përputhje me pamjen e Krishtit. (Rom. 12:1,2).

Ky progres nuk ndodh gjithmonë, megjithatë. Kemi menduar pak për ndodhinë e dhimbshme të quajtur “kthim mbrapsht” (një rrëshkitje mbrapsht e qetë nga Krishti) dhe “apostazi” (një hedhje poshtë publike e tij). Këto kanë shkaqe të ndryshme. Disa njerëz i kthejnë kurrizin Krishtit kur i ikën mahnitja nga kisha; të tjerë i dorëzohen presioneve të sekularizmit ose të kulturës së tyre të kaluar. Këto fakte na sfidojnë si të shpallim ungjillin e plotë ashtu edhe të jemi më të ndërgjegjshëm në ushqimin e besimtarëve të rinj në besim dhe në stërvitjen e tyre për shërbim.

Një anëtar i Konsultës tonë e ka përshkruar përjetimin e tij në termat e kthimit së pari te Krishti (duke marrë shpëtimin e tij dhe njohur zotërinë e tij), së dyti ndaj kulturës (duke rizbuluar origjinën e tij natyrore dhe identitetin e tij), dhe së treti ndaj botës (duke pranuar misionin në të cilin Krishti e dërgoi). Biem dakort që konvertimi është shpesh një përjetim i komplikuar, dhe që gjuha biblike e “kthimit” përdoret në mënyra dhe kontekste të ndryshme. Në të njëjtën kohë, ne të gjithë theksojmë që përkushtimi personal ndaj Jezus Krishtit është themelor. Vetëm në të gjejmë shpëtim, jetë të re, dhe identitet personal. Konvertimi duhet të rezultojë gjithashtu në qëndrime dhe marrdhënie të reja, dhe të drejtojnë në një përfshirje të përgjegjshme në kishën, kulturën dhe botën tonë. Së fundi, konvertimi është një udhëtim, një piligrimazh, me sfida gjithmonë të reja, vendime dhe kthime te Zoti si një pikë referimi e vazhdueshme, derisa ai të vijë.

Pyetje për Diskutim

1. Trego ndryshimin midis “ripërtëritjes” dhe “konvertimit” në bazë të Dhjatës së Re.
2. "Jezusi është Zot." Çfarë do të thotë për ju në kulturën tuaj? Shikoni Seksionin 7 b dhe d. Cilët janë elementët e traditës tuaj kulturore të cilët ndeni se (a) ju duhet, dhe (b) ju nuk duhet, të hidhni poshtë për shkak të Krishtit?
3. Çfarë është e befasishme dhe çfarë është (ose çfarë mund të jetë) e ngadalshme në konvertimin e krishterë?

8. Kisha dhe Kultura

Në procesin e formimit të kishës, si në komunikimin dhe marrjen e ungjillit, pyetja e kulturës është jetësore. Nëse ungjilli duhet të vihet në kontekst, kështu duhet edhe kisha. Me të vërtetë, nën-titulli i Konsultës tonë ka qenë “kontekstualizimi i Fjalës dhe Kishës në situatën misionare.”

A. Mënyra të Vjetra, Tradicionale

Gjatë zgjerimit misionar në fillimet e shekullit të 19, merrej si fakt që kishat “në fushën e misionit” duhet të ishin modeluar sipas kishave “në shtëpi”. Tendenca ishte të prodhohej gati të njëjtat kopje. Arkitektura gotike, liturgjitë e librave të lutjes, rrobat fetare, instrumentet muzikore, himnet dhe muzika, proceset e marrjes së vendimeve, sinodet

dhe komitetet, mbikqyrësit dhe mbidhjakët—të gjithë janë eksportuar dhe pa asnjë imagjinatë futur në kishat e themeluara misionare. Duhet të shtohet që këto shabllone janë pranuar nga të krishterët e rinj, të vendosur që të mos mbeten në asnjë pikë mbrapa miqve të tyre perëndimorë, zakonet dhe rrugët e adhurimit të të cilëve ata ndiqnin me kujdes. Por e gjithë kjo ishte bazuar në paramendimet e rreme që Bibla dha udhëzime të veçanta për çështje të tilla dhe që shablloni i qeverisjes, adhurimit, shërbesës dhe jetës i kishave nënë ishin shembullorë.

Në kundërsulm ndaj këtij sistemi eksporti monokulturor, mendimtarë misionarë të veçantë si Henry Venn dhe Rufus Anderson në mesin e shekullit të kaluar dhe Roland Allen herët në fillim të shekullit popullarizuan konceptin e kishave “vendore”, të cilat do të ishin “vetë-qeverisëse, vetë-financuese dhe vetë-shpërndarëse”. Ata e mbrojtën çështjen e tyre mirë. Treguan faktin që praktika e apostullit Pal ishte të mbillte kisha, jo të themelonte stacione misionarësh. Gjithashtu shtuan argumente të dobishme ndaj atyre biblike, me një fjalë që qenija vendase e kishës është e domosdoshme për rritje e saj në pjekuri dhe mision. Henry Venn me besim priste për ditën kur misionet do ti dorëzonin gjithë përgjegjësitë kishave kombëtare, dhe pas kësaj ajo që ai quan “eutanzia e misionit” do të ndodhte. Këto pikëpamje u pranuan gjërësisht dhe patën shumë influencë.

Në ditët e sotme, sidomos, ata po kritikohen, jo vetëm për shkak të idealit, por për shkak të mënyrës që u vendos në punë. Disa misione, për shembull, kanë pranuar nevojën për udhëheqjen vendase dhe pastaj kanë rekrutuar dhe stërvitur udhëheqës vendas, duke i indokrinuar ata (fjala është e rreptë, por e drejtë) në rrugët perëndimore të mendimit dhe procedurës. Këto udhëheqës vendorë pro perëndimorë kanë ruajtur në këtë mënyrë një kishë me pamje perëndimore, dhe orientimi i huaj ka zgjatur, vetë se ka qenë i fshehur lehtë me pamjen vendase.

Tani, pra, duhet të zhvillohet një koncept më radikal i jetës së kishës vendase, me anë të së cilit çdo kishë mund të zbulojë dhe shprehë veten e saj si trupi i Krishtit brenda kulturës së saj.

B. Modeli i Njësisë Dinamike

Duke përdorur ndryshimet midis “formës” dhe “kuptimit”, dhe midis “korrespondencës zyrtare” dhe “njësisë dinamike”, të cilat janë zhvilluar në teorinë përkthyesë dhe mbi të cilat ne kemi komentuar në Seksionin 3, është dhënë mendimi që një analogji mund të tregohet midis përkthimit të Biblës dhe formimit të kishës. “Korrespondenca zyrtare” flet për një imitim prej skllavi, qoftë në përkthimin e një fjale apo në eksportimin e një modeli kishe në një kulturë tjetër. Ashtu si një përkthim i “njësisë dinamike” përpiket të ti kalojë lexuesve të tanishëm një kuptim të përafërt me atë që i jepte lexuesve fillestarë, duke përdorur forma kulturore të duhura, kështu do të bënte edhe një kishë e “njësisë dinamike”. Do të dukej aq mirë në kulturën e saj aq sa një përkthim i Biblës do të dukej në gjuhën e saj. Do të ruante kuptimin dhe rolin e saj fillestar për të cilin Dhjata e Re parashikoi për kishën, por do të kërkonte ti shprehte këto në forma të njëjta me origjinalin por të përputhshme me kulturën vendase.

Të gjithë ne e kemi praknuar që ky model është ndihmës dhe i mahnitshëm, dhe pohojmë me forcë të gjitha idealet që ai do të shprehë. Hedh poshtë me të drejtë importimet dhe imitimet e huaja, si dhe strukturat e forta. Shikon me të drejtë tek Dhjata e Re për parimet e formimit të kishës, në vend që të shohë te tradita ose kultura, dhe me të njëjtën të drejtë shikon kulturën vendase për forma të duhura në të cilat këto

parime duhet të shprehen. Të gjithë ne (edhe ato që mbajnë rezerva për kufizimet e modelit) ndajnë vizionin që përpiqet të shprehë.

Kështu, Dhjata e Re tregon që kisha është gjithmonë një bashkësi adhuese, një “priftëri e shenjtë që i ofron sakrifica shpirtërore Perëndisë nëpërmjet Jezus Krishtit” (1 Pjet. 2:5), por forma adhurimi (duke përfshirë praninë apo mungesën e llojeve të ndryshme të liturgjisë, ceremonive, muzikës, ngjyrave, dramave, etj.) do të zhvillohen nga kisha në besnikëri të kulturës vendase. Ngjashëm, kisha është gjithmonë një bashkësi dëshmuese dhe shërbyese, por metodat e ungjillizimit dhe programit të saj të përfshirjes shoqërore do të jetë e ndryshueshme. Përsëri, Perëndia dëshiron të gjitha kishat të kenë mbishikim pastoral (*episkope*), por format e qeverisjes dhe shërbesës mund të ndryshojnë shumë, dhe zgjedhja, trainimi, vendosja, shërbimi, veshja, pagesa dhe përgjegjësia e pastorëve do të përcaktohet nga kisha që të përputhet me parimet biblike dhe ti përputhet kulturës vendase.

Pyetjet që shtrohen për modelin e “njësisë dinamike” janë nëse në vetvete është mjaftueshëm i madh që të japë gjithë drejtimin e duhur. Analogjia midis përkthimit biblik dhe formimit të kishës nuk është e saktë. Në të parën përkthyesi kontrollon punën, dhe kur puna mbarohet jepet mundësia e krahasimit të dy teksteve. Në të dytën, përkundrazi, origjinali për të cilin një ekuivalent po kërkohet nuk është një tekst i detajuar por një numër vështirësish nga kisha e hershme në punë e sipër, duke bërë krahasimin më të vështirë, dhe në vend që të një përkthyesi kontrollues, e gjithë bashkësia e besimit duhet të përfshihet. Më tej, një përkthyes qëllon në objektivitetin personal, por kur kisha vendore kërkon lidhjet e saj të vërteta me kulturën ashtu si duhet, e kupton që objektiviteti është pothuajse i pamundur. Në shumë situata gjendet në një “takim midis dy civilizimeve” (domethënë midis shoqërisë së saj dhe atë të misionarëve). Për më tepër, mund të ketë vështirësi të mëdha në përgjigjen ndaj zërave konfliktues të bashkësisë vendase. Disa thërrasin për ndryshim (në anën e edukimit, teknologjisë, shkencës bashkëkohore, industrializimit, etj.), ndërsa të tjerë ngulin këmbë në ruajtjen e kulturës së vjetër dhe rezistojnë ardhjen e ditës së re. Shtrohet pyetja nëse modeli i “njësisë dinamike” është aq dinamik sa të ballafaqohet me një sfidë të tillë.

Testi i kësaj apo ndonjë modeli tjetër që ndihmon në zhvillimin e duhur të kishave, është nëse mund ti mundësojë njerëzit e Perëndisë për të kapur në zemrat dhe mendjet e tyre planin e madh e të cilit kisha e tyre do të jetë shprehja vendore. Çdo model jep vetëm një pamje të pjesshme. Kishat vendore duhet të mbështeten përfundimisht në presionin dinamik të Zotit të Gjallë të historisë. Sepse është ai që do ti udhëheqë njerëzit e tij në çdo erë për të zhvilluar jetën e kishës së tyre në një mënyrë të tillë që ti binden udhëzimeve që ai ka dhënë në Shkrimet dhe të pasqyrojnë pjesët e mira të kulturës së tyre vendore.

C. Liria e Kishës

Nëse çdo kishë do të zhvillohej krijueshëm në një mënyrë të tillë që të gjente dhe shprehte veten, duhet të jetë e lirë të bëjë një gjë të tillë. Kjo është e drejta e saj e padiskutueshme. Çdo kishë është kisha e Perëndisë. E bashkuar me Krishtin, është një vend jetese i Perëndisë nëpërmjet Shpirti të tij (Efes. 2:22). Disa misione dhe misionarë kanë qenë të ngadalshëm për ta njohur këtë, dhe të pranojnë pasojat në drejtimin e formave vendase dhe një shërbesë çdo-anëtarë. Kjo është një nga shkaqet e shumta të

cilat kanë çuar në formimin e Kishave të Pavarura, sidomos në Afrikë, të cilat kërkojnë mënyra të reja vetë-shprehje në termat e kulturës së tyre vendase.

Megjithëse udhëheqësit e kishave vendore disa herë kanë penguar zhvillimin vendor, faji kryesor qëndron në vend tjetër. Nuk do të ishte e drejtë të përgjithësohej. Situata ka qenë gjithmonë e ndryshme. Në breza paraardhës ka pasur misione që kurrë nuk kanë treguar një shpirt mbizotërimi. Në këtë shekull disa kisha kanë dalë që nuk kanë qenë asnjëherë nën kontrollin misionar, dhe që kanë gëzuar vetë-qeverisje që nga fillimi. Në raste të tjera misionet i kanë dorëzuar plotësisht fuqitë e tyre të mëparshme, kështu që disa kisha të themeluara nga misionet tani janë plotësisht të pavarura, dhe shumë misione tani punojnë në ortakëri të vërtetë me kishat.

Megjithatë, kjo nuk është pamja e plotë. Kisha të tjera janë akoma pothuajse plotësisht të bllokuara në zhvillimin e identitetit dhe programit të tyre nga plane të bëra nga larg, nga futja dhe vazhdimi i traditave të huaja, nga përdorimi i udhëheqjes jokombëtare, nga procese marrje vendimesh të huaja, dhe sidomos nga përdorimi manipulues i parasë. Ata që mbajnë një kontroll të tillë duhet me të vërtetë të mos jenë në dijeni për mënyrën në të cilën veprimet e tyre shihen dhe përjetohen në anën tjetër. Nga kishat në fjalë ato mund të përjetohen si të jenë tirani. Fakti që as nuk duan dhe as nuk bëhen ilustron në mënyrë të përsosur si të gjithë ne (nese e dimë apo jo) jemi të përfshirë në kulturën e cila na ka bërë ne ajo që ne jemi. Me forcë e kundërshtojmë një “falje” të tillë, kudo që të jetë në jetë, si një pengesë serioze ndaj pjekurisë dhe misionit, dhe një fikje e Shpirtit të Shenjtë të Perëndisë.

Ishte në protestë ndaj vazhdimit të kontrollit të huaj që disa vjet më parë që një thirrje u bë për tërheqjen e misionarëve. Në këtë debat disa nga ne duan të mënjanojnë fjalën “moratorium” sepse është bërë një term emotiv dhe disa herë jep një urrejtje ndaj vetë konceptit të “misionarëve”. Të tjerë nga ne duan ta mbajnë fjalën në mënyrë që të theksojnë të vërtetën që ajo shpreh. Për ne do të thotë jo një hedhje poshtë e personelit misionar dhe parasë në vetvete, por vetëm keqpërdorimi i tyre në mënyrë të tillë që të mbysë iniciativën vendase. Të gjithë biem dakort me thënien e Konventës së Lozanës që “një ulje e numrit të misionarëve të huaj dhe parasë...mund të jetë e nevojshme disa here për të ndihmuar rritjen e kishës vendase në vetë-besim...” (para. 9).

D. Strukturat e Fuqisë dhe Misioni

Kjo që sapo kemi shkruar është pjesë e një problemi shumë më të gjërë, të cilin nuk kemi ndjerë se e lëmë dot pas dore. Bota e sotme nuk përbëhet nga shoqëri të veçuara atomike, por është një sistem i ndërlidhur botëror ekonomik, politik, teknologjik dhe makro-struktura ideologjike, që padyshim përfundon në shfrytëzim dhe shtypje të shumtë.

Çfarë ka kjo të bëjë me misionin? Dhe përse e ngremë këtu? Pjesërisht sepse është konteksti brenda së cilit ungjilli duhet të predikohet në të gjitha kombet sot. Pjesërisht gjithashtu sepse shumica prej nesh ose janë nga bota e tretë, ose jetojnë dhe punojnë atje, ose kanë qenë duke bërë këtë, ose kanë qenë në disa nga këto vende. Kështu ne e kemi parë me sytë tanë varfërinë e masave, ne ndjejmë me ta dhe për ta, dhe kemi një farë kuptimi që gjendja e tyre është pjesërisht për shkak të një sistemi ekonomik që kontrollohet shumë nga vendet Veri Atlantike (megjithëse të tjerë janë përfshirë në të gjithashtu tani). Ata nga ne që janë shtetas të vendeve Amerikano-Veriore dhe Europiane nuk mund të mos ndjejnë një farë ndjenjë turpi, për shkak të shtypjes në të

cilën vendet tona janë përfshirë në shkallë të ndryshme. Sigurisht, dimë që ka shtypje në shumë kultura sot, dhe ne e kundërshtojmë atë në çdo vend. Por tani po flasim për veten tonë, vendet tona dhe përgjegjësitë tona si të krishterë. Shumica e misionarëve të botës dhe e parave për misionarët vijnë nga këto vende, shumë herë me sakrifica të vërteta personale. Megjithatë duhet të rrëfejme që disa misionarë pasqyrojnë një sjellje neo-koloniale dhe madje edhe e mbrojnë, së bashku me simbolet e fuqisë dhe shfrytëzimit perëndimor si në jugun e Afrikës.

Çfarë duhet të bëjmë, pra? Përgjigjja e vetme e ndershme është të themi se nuk e dimë. Kritikat burokratike janë hipokrizi. Nuk kemi zgjidhje të gatshme për të ofruar për këtë problem mbarëbotëror. Me të vërtetë, ne ndihemi viktima të sistemit vetë Megjithatë ne jemi pjesë e saj. Kështu që ndiejmë që duhet të japim vetëm këto komente.

Së pari, Jezusi vetë vazhdimisht identifikohet me të varfërit dhe të dobëtit. Ne e pranojmë detyrimin të ndjekim hapat e tij në këtë çështje si dhe në të tjera. Të paktën me anë të dashurisë e cila lutet dhe jep ne duam të forcojmë solidaritetin tonë me ta.

Jezusi bëri më shumë sesa të identifikohet. Në mësimin e tij dhe atë të apostujve thelbi i lajmit të mirë për të shtypurit ishte një fjalë gjykimi për shtypësin (p.sh., Luka 6:24-26; Jak. 5:1-6). Rrëfejme se në situata ekonomike të ndërlikuara nuk është e lehtë të identifikosh shtypësit në mënyrë që ti denoncojmë pa një retorikë të ashpër që as kushton dhe as arrin gjë. Megjithatë, ne pranojmë që do të ketë raste që do të jetë detyra jonë e krishterë që të flasim kundër padrejtësive në emër të Zotit i cili është Perëndia i drejtësisë ashtu siç është i justifikimit. Do të kërkojmë prej tij kurajon dhe mençurinë për të bërë këtë.

Së treti, ky Konsultim ka shprehur shqetësimin për sinkretizmin në kishat e Botës së Tretë. Por nuk kemi harruar që kishat perëndimore bien pre e të njëjtit mëkat. Me të vërtetë, ndoshta forma më e keqe e sinkretizmit në botë sot është përpjekja për të përzier një ungjill të privatizuar të faljes personale me një qëndrim të botës (madje demonik) ndaj paurisë dhe fuqisë. Ne vetë nuk jemi të pafajshëm në këtë çështje. Megjithatë dëshirojmë të jemi të krishterë të integruar për të cilët Jezusi është me të vërtetë Zot i gjithçkaje. Kështu, ne që i përkasim, ose vijmë nga perëndimi do të shikojmë veten tonë dhe kërkojmë të pastrojmë veten tonë nga sinkretizmi i stilit perëndimor. Biem dakort që “shpëtimi që ne shpallim duhet të na transformojë në përgjithësinë e përgjegjësive tona personale dhe sociale. Besimi pa vepra është i vdekur” (Konventa e Lozanës, para. 5)

E. Rreziku i Provincializmit

Kemi theksuar që kisha duhet të lejohet të bëhet vendore, dhe të “festojë, këndojë dhe kërcejë” ungjillin në mënyrën e vet kulturore. Në të njëjtën kohë, duam të jemi në dijeni të rrezqeve të këtij procesi. Disa kisha në të gjithë gjashtë kontinentet shkojnë më tej një zbulimi të gëzueshëm dhe falenderues, dhe ose të bëhemi krenarë dhe forcues për të (një formë shovinizmi) ose ta absolutizojmë atë (një formë idhujtarie). Më e shpeshtë se secila nga këto ekstreme, megjithatë, është “provincializmi”, domethënë një tëheqje aq e madhe në kulturën e vet aq sa i pret nga pjesa tjetër e kishës dhe nga bota e gjërë. Ky është një qëndrim i shpeshtë në kishat perëndimore si dhe në ato të botës së tretë. Mohon Perëndinë e krijimit dhe shpengimit. Është të shpallësh lirinë e vetes, vetëm që

të futesh në një robëri tjetër. Ne tërheqim vëmendjen të tre arsyt kryesore që ne mendojmë se pse një qëndrim i tillë duhet mënjanuar.

Së pari, çdo kishë është pjesë e kishës universale. Njerëzit e Perëndisë janë me anë të hirit të tij janë një bashkësi e veçantë multi- raciale, multi-kombëtare dhe multi-kulturore. Kjo bashkësi është krijesa e re e Perëndisë, njerëzia e re e tij, në të cilën Krishti ka hedhur poshtë të gjitha barrierat (shiko Efesianët 2 dhe 3). Nuk ka pra, vend për racizëm në shoqërinë e krishterë, ose për tribalizëm—qoftë në fomën e tij afrikane, ose në formën e klasave shoqërore europiane, apo në sistemin e kasave indian. Me gjithë dështimet e kishës, vizioni i një bashkësie mbi-etnike dashurie nuk është një ideal romantik, por një urdhëresë e Zotit. Pra, duke u gëzuar në trashëgiminë tonë kulturore dhe duke zhvilluar format tona vendase, duhet të kujtojmë gjithmonë që identiteti ynë kryesor si të krishterë nuk është në kulturën tonë të veçantë por në një Zot dhe trupin e tij (Efes. 4:3-6).

Së dyti, çdo kishë adhuron Perëndinë e gjallë të shumëllojshmërisë kulturore. Nëse duam ta falenderojmë atë për trashëgiminë tonë kulturore, duhet ta falenderojmë atë edhe për atë të të tjerëve gjithashtu. Kisha jonë kurrë nuk duhet të jetë aq e lidhur me kulturën e vet sa vizitorët nga një kulturë tjetër të ndihen të paftuar. Me të vërtetë, besojmë se është pasuruese për të krishterët, nëse kanë mundësinë, të zhvillojnë një jetesë dy-kulturore dhe edhe mundësisht shumë-kulturore, si apostulli Pal i cili ishte si hebre hebrejsh, ashtu edhe një mjeshër i gjuhës greke, dhe një shtetas romak.

Së treti, çdo kishë duhet të hyjë në një “ortakëri...në dhënien dhe marrjen” (Fil. 4:15). Asnjë kishë nuk është, ose duhet të përpiqet të bëhet vetë-mbajtëse. Kështu kishat duhet të zhvillojnë me njëra tjetrën marrdhënije lutjeje, bashkësie, shkëmbim shërbese dhe bashkëpunimi. Nëse ndajmë në të njëjtat të vërteta qëndrore (duke përfshirë zotërinë superiore të Krishtit, autoritetin e Shkrimeve, nevojën e konvertimit, besimin në fuqinë e Shpirtit të Shenjtë, detyrimet e shenjtërisë dhe dëshmimit), ne duhet të jemi të qartë dhe jo të turpshëm në kërkimin e bashkësisë; ne duhet të ndajmë dhuntitë tona shpirtërore dhe shërbesat, njohuritë, aftësitë, eksperiencën, dhe burimet financiare. I njëjti parim i zbatohet kulturës. Një kishë duhet të jetë e lirë të hedhë poshtë format e huaja dhe të zhvillojë të vetat; duhet gjithashtu të ndjehet e lirë të marrë borxh nga të tjerat. Në këtë rrugë është pjekuria.

Një shembull i kësaj i referohet teologjisë. Dëshmia ndër-kulturore nuk duhet të përpiqet të vendosë me dhunë një traditë teologjike të gatshme mbi kishën në të cilën ata shërbejnë, qoftë me anë të mësimin personal ose me anë të literaturës qoftë me anë të kontrollit të kurikulumeve të kolegjeve dhe shkollave biblike. Çdo traditë teologjike përmban si elementë të cilët janë të pyetshëm nga ana biblike dhe kanë qenë ndarës kishtarë ashtu edhe lë jashtë elementë të cilët, ndërsa mund të mos kenë asnjë pasojë të madhe në vendin nga kanë dalë, mund të jenë të një rëndësie të veçantë në kontekste të tjera. Në të njëjtën kohë, megjithëse misionarët nuk duhet të vendosin me forcë traditat e tyre mbi të tjerët, ata as nuk duhet të mos ti lejojnë hyrje në të (në formë e librave, rrëfimeve, katekizmave, liturgjive dhe himneve), meqenëse pa dyshim përfaqëson një trashëgimi të pasur besimi. Për më tepër, megjithëse argumentet teologjike të kishave më të vjetra nuk duhet të eksportohen në kishat e reja, por një kuptim i çështjeve, dhe të punës së Shpirtit të Shenjtë në hapjen e historisë së doktrinës së krishterë, duhet të ndihmojë ti mbrojë ata nga përsëritjet e papërfitueshme të disa betejave.

Kështu, duhet të kërkojmë me kujdes të njëjtë të shmangim imperializmin apo provincializmin teologjik. Teologjija e një kisha duhet të zhvillohet nga një bashkësi besimtare nga Shkrimet në ndërveprim me teologji të tjera të së kaluarës dhe së tashmes, me kulturën vendase dhe nevojat e saj.

F. Rreziku i sinkretizmit

Ndërsa kisha kërkon të shprehë jetën e saj në format kulturore vendore, shumë shpejt do të ballafaqohet me problemin e elementeve kulturore të cilat ose janë të liga ose kanë lidhje të liga. Si do të reagojë kisha ndaj tyre? Elementët që janë tërësisht të rremë ose të ligë është e qartë që nuk mund të asimilohen në krishtërim pa një lëvizje drejt sinkretizmit. Ky është një rrezik për të gjitha kishat në të gjitha kulturat. Nëse e liga është vetëm në lidhje me, atëherë, besojmë që është e drejtë të kërkojmë “pagëzimin” e saj në Krishtin. Është parimi mbi të cilin William Booth veprimi kur vendosi fjalët e krishtera në muzikën e tij bashkëkohore, duke thënë pse të ketë djalli muzikën më të mirë. Kështu shumë kisha afrikane tani përdorin daulle për të thërritur njerëzit në adhurim, megjithëse më përpara ato ishin të papranueshme, si të lidhura me kërcimet luftarake dhe ritet shtrigane.

Por ky parimi ngren probleme. Në një reagim kundër të huajve, një shoqërim i padëshiruar me elementin demonik të kulturës lokale ndodh disa herë. Kështu që kisha, duke qenë së pari dhe parësisht një shërbëtor i Jezus Krishtit, duhet të mësojë të hulumtojë të gjithë kulturat, të huaja dhe vendase, në dritën e zotërisë së tij dhe zbulesës së Perëndisë. Në bazë të cilave drejtimeve, pra, pranon ose hedh poshtë kisha pjesët e kulturës në procesin e kontekstualizimit? Si i parandalon ose gjen dhe eliminon herezitë (mësimet e gabuara) dhe sinkretizmit (gjëra të këqija të marra me vete që janë nga jeta e vjetër)? Si e mbron veten nga të bërit e një “kisha popullore” në të cilën kisha dhe shoqëria janë aq shumë si sinonime?

Një model i veçantë që kemi studiuar është ai i kishës në Bali, Indonezi, e cila është rreth 40 vjet i vjetër. Eksperienca e saj ka dhënë pikat e mëposhtme:

Bashkësia besimtare së pari hulumtoi Shkrimet dhe mësoi prej tyre shumë të vërteta të rëndësishme biblike. Më pas ata vëzhguan që kishat e tjera (p.sh. rreth Mesdheut) përdorin arkitekturën për të simbolizuar të vërtetat e krishtera. Kjo ishte shumë e rëndësishme sepse njerëzit e Balit janë njerëz shumë “vizualë” dhe i vlerësojnë shenjat e dukshme. Kështu u vendos, për shembull, për të shprehur pohimin e tyre të besimit në Trininë në mënyrën balineze të tavanit me tre shtresa për kishat e tyre. Simboli fillimisht u shqyrtua nga pleqtë e kishës, të cilët mbas shqyrtimit të faktorëve si biblikë ashtu edhe kulturorë, ja rekomanduan bashkësive vendase.

Zbulimi dhe eliminimi i herezve ndoqi një shembull të njëjtë. Kur besimtarët dyshojnë për një gabim në jetë ose në mësim, ata do ta trgonin atë të një dhjak, i cili do ta çonte te pleqtë e kishës. Pasi e kanë shqyrtuar çështjen, ata nga ana e tyre i kaluan këshillat e tyre te kishat vendase që kanë fjalën e fundit.

Cila ishte mbrojtja më e rëndësishme e kishës? Përgjigja e kësaj pyetje ishte: “Besojmë që Jezus Krishti është Zot dhe Mjeshtër i të gjitha fuqive”. Duke predikuar fuqinë e tij, “e njëjta dje dhe sot dhe gjithmonë”, duke ngulur këmbë gjat gjithë kohës në natyrën normative të Shkrimeve, duke besuar pleqtë me detyrimin për të menduar mbi Shkrimet dhe kulturën, duke thyer të gjitha pengesat ndaj bashkësisë, dhe duke ndërtuar në

strukturat, katekizmin, forma arti, drama, etj., kujtues të vazhdueshëm të pozitës së ngritur të Jezus Krishtit, kisha e tij është ruajtur në vërtetësi dhe shenjtëri.

Disa herë, në pjesë të ndryshme të botës, ndonjë element kulturor mund të adoptohet i cili me të vërtetë shqetëson ndërgjegjjet shumë të ndjeshme, sidomos ato të sapo konvertuarve. Ky është problemi i “vëllait më të dobët” për të cilin Pali flet në lidhje me mishin e idhujve. Meqenëse idhujt nuk ishin asgjë, Pali vetë pati lirinë për ti ngrënë këto mishra. Por, për hir të të krishterëve “më të dobët” me një ndërgjegje të edukuar më pak, të cilët do të ofendoheshin po ta shikonin që ai hante mish, ai u përmbajt, të paktën në situata të veçanta në të cilat një fyerje e tillë mund të ndodhte. Ky parim akoma vepron sot. Shkrimet e marrin ndërgjegjjen seriozisht dhe na thonë neve të mos ta thyejmë atë. Duhet të edukohet në mënyrë që të bëhet “i fortë”, por ndërsa mbetet “i dobët” duhet respektuar. Një ndërgjegje e fortë do të na japi në lirinë; por dashuria e kufizon lirinë.

G. Influenca e Kishës në kulturë

E shtyjme mënjane pesimizmin i cili i udhëheq disa të krishterë të mos bien dakort me përfshirjen aktive kulturore në botë, dhe qëndrimin e mundur që i bind të tjerët që nuk mund të bënin asgjë të mirë atje në çdo rast, dhe prandaj duhet të presin në qetësi sepse Krishti do ti vërë gjërat në vend kur të vijë. Shumë shembuj historikë mund të jepen, të nxjerra nga era dhe vende të ndryshme, të influencës së fuqishme nën të cilën—nën Perëndinë—kisha ka vepruar në kulturën mbizotëruese, duke pastruar, marrë dhe zburuar për Krishtin. Megjithëse të gjithë shembujt e tillë kanë pasur defekte, ata nuk e provojnë që e gjithë ndërmarrja ka dështuar.

Preferojmë, megjithatë, të bazojmë përgjegjësinë kulturore të kishës mbi Shkrimet sesa mbi historinë. E kemi kujtuar veten se shokët dhe shoqet tanë janë bërë në imazhin e Perëndisë, dhe se ne jemi urdhëruar ti nderojmë, duam dhe ti shërbejmë atyre në çdo sferë të jetës. Këtij argumenti nga krijimi i Perëndisë i shtojmë një tjetër nga mbretëria e tij që u fut në botë nëpërmjet Krishtit. I gjithë autoriteti i përket Krishtit. Ai është zot si i universit ashtu edhe i kishës. Dhe ai na ka dërguar ne në botë të jemi kripa dhe drita e tij. Si bashkësia e tij e re, ai pret prej nesh të futemi në shoqëri.

Kështu ne duam të sfidojmë atë që është e ligë dhe të pohojmë atë që është e mirë; të mirëpresim dhe kërkojmë të reklamojmë gjithçka që është plotësuese dhe pasuruese në art, shkencë, teknologji, bujqësi, industri, edukim, zhvillim bashkësie dhe sigurimet shoqërore; të denoncojmë padrejtësinë dhe mbrojmë të pafuqishmit dhe të shtypurit; të përhapim lajmin e mirë të Jezus Krishtit, që është forca më çliruese dhe njerëzore në botë; dhe në mënyrë aktive të përfshihemi në punë të mira dashurie. Megjithëse, në veprimtari shoqërore dhe kulturore si në ungjillizim, duhet t’ia lëmë rezultatet Perëndisë, besojmë që ai do ti bekojë përpjekjet tona dhe ti përdorë ato për të zhvilluar në bashkësinë tonë një ndërgjegjshmëri të re të asaj që është “e vërtetë, fisnike, e drejtë, e pastër, e dashur, dhe e ndershme” (Fil. 4:8). Sigurisht, kisha nuk mund të vendosë me forcë standarte të krishtera mbi një shoqëri që nuk do, por mund ti ngrejë ata me argument dhe shembull. E gjithë kjo do ti sjelli lavdi Perëndisë dhe mundësi më të mëdha të njerëzimit për shokët tanë të cilët ai i ka krijuar dhe i do. Siç e thotë Konventa e Lozanës, “kishat duhet të kërkojnë të transformojë dhe pasurojnë kulturën, e gjithë kjo për lavdinë e Perëndisë” (para. 10).

Megjithatë, optimizmi naiv është aq i pakuptimtë sa pesimizmi i errët. Në vend të të dyjave, kërkojmë një realizëm të vërtetë të krishterë. Në një rën anë, Jezus Krishti mbretëron. Në tjetrën, ai akoma nuk i ka shkatërruar forcat e së ligës; ata akoma janë të lira. Kështu në çdo kulturë të krishterët e gjejnë veten e tyre në situatë konflikti dhe shpeshherë vuajtje. Jemi të thirrur të luftojmë kundër “fuqive kozmike të kësaj ere të errët” (Efes. 6:12). Kështu që kemi nevojë për njëri tjetrin. Duhet të veshim armurën e Perëndisë, dhe sidomos armën e fuqishme të lutjes besimtare. Gjithashtu duhet të kujtojmë paralajmërimet e Krishtit dhe apostujve të tij që përpara fundit do të ketë një derdhje të paparë të ligësisë dhe dhunës. Disa ngjarje dhe zhvillime në botën tonë të sotshme tregojnë që shpirti i Antikrishtit që vjen është duke punuar tashmë jo vetëm në botën jo të krishterë, por edhe në shoqëritë tona pjesërisht të krishterizuara dhe madje edhe në vetë kishat. “Ne atëherë e hedhim poshtë si një ëndërr krenare, vetë-besimtare konceptin që njeriu mund të ndërtojë utopi mbi tokë” (Konventa e Loozanës, para 15), dhe si një fantazi e pabazë që shoqëria do të zhvillohet në përsosmëri.

Por në vend të saj, ndërsa punojmë me vrull në tokë, presim me padurim e me gëzim rikthimin e Krishtit, dhe për qiellin e ri dhe tokën e re në të cilën drejtësia do të qëndrojë. Sepse atëherë jo vetëm që kultura do të ndryshohet, ndërsa kombet sjellin lavdinë e tyre në Jeruzalemin e Ri (Zbul. 21:24-26) por i gjithë krijimi do të çlirohet nga robëria e sotshme e panevojshme, shkatërrimi dhe vuajtja, kështu që të ndajë lirinë e lavdishme të fëmijëve të Perëndisë (Rom. 8:18-25). Pastaj, më në fund çdo gju do të përulet ndaj Krishtit dhe çdo gjuhë të shpallë haptazi që ai është Zot, për lavdinë e Perëndisë Atë (Fil. 2:9-11).

Pyetje për Diskutim

1. A është kisha juaj “e lirë” të zhvillojë veten e saj? Nëse jo, çfarë forcash e pengojnë? Shiko Seksionin 8 a-d.
2. Seksioni 8d ka disa gjëra të rënda për të thënë për “strukturat e fuqive”. A bieni dakort? Nëse po, a mund të bëni ndonjë gjë për të?
3. "Provincializmi" (8e) dhe "sinkretizmi" (8f) janë të dy gabime të një kisha e cila po përpiqet të shprehë identitetin në format vendore, kulturore. A po bën kisha juaj njërin nga dy gabimet? Si mund të shmangen pa hedhur poshtë kulturën vendase?
4. A duhet të përpiqet më shumë kisha në vendin tuaj të “transformojë dhe pasurojë” kulturën kombëtare? Nëse po, në cilën mënyrë?

9. Kultura, Etika dhe Jetesa e Krishterë

Duke pasur marrë parasysh Seksionin 7 disa nga faktorët kulturorë në konvertimin e krishterë, do të fijmë përfundimisht në marrdhëniet midis kulturës dhe sjelljes etike së krishterë. Për jetën e re të krishterë që Krishti i jep popullit të tij është i detyruar të japë një jetesë së re.

A. Krishto-qendrimi dhe Krishto-ngjashmëria

Një nga temat që depërton në të gjithë Konsultën tonë është Zotëria supreme e Jezus Krishtit. Ai është Zot i universit dhe i kishës; ai është Zot i besimtarit gjithashtu. Ne e shohim veten të mbërthyer në dashurinë e Krishtit. Na rrethon dhe nuk na lë rrugëdalje. Për arsye se gëzojmë risinë e jetës nëpërmjet vdekjes së tij, nuk kemi asnjë zgjidhje tjetër (dhe nuk dëshirojmë të kemi) përveçse të të jetojmë për të që vdiq dhe u ngrit përsëri (2 Kor. 5:14,15). Bindja jonë e parë është ndaj tij, të përpiqemi ta kënaqim atë, të jetojmë një jetë të kënaqshme për të, dhe ti bindemi atij. Kjo krijon nevojën e dorëzimit të pasurive më të vogla. Kështu neve na është e ndaluar që të përshtasim veten ndaj standarteve të kësaj bote, domethënë, ndaj çdo kulture që nuk nderon Perëndinë, dhe jemi urdhëruar të transformohemi në sjelljen tonë me mendjet e ndryshuaratë cilat kuptojnë vullnetin e Perëndisë.

Vullnetit të Perëndisë iu bind plotësisht Jezusi. Pra, “gjëja më e rëndësishme për një të krishterë nuk duhet të jetë kultura, por ngjashmëria e tij me Krishtin”. Siç e thotë *Letra e drejtuar Diogjenit* e mesit të shekullit të dytë: “Të krishterët nuk dallohen nga pjesa tjetër e njerëzimit nga kombi ose e folura ose nga zakonet...ata ndjekin zakonet e vendit në veshje dhe ushqim dhe në pjesë të tjera të jetës së përditshme, megjithatë gjendja e shtetësisë së tyre që ata tregojnë është e mrekullueshme...Me fjalë të tjera, ajo që shpirti është në një trup, ajo janë të krishterët në botë.”

B. Standartet Morale dhe Praktikrat Kulturore

Kultura nuk është asnjëherë e palëvizshme. Ndryshon si nga vendi në vend ashtu edhe nga koha në kohë. Gjatë gjithë historisë së gjatë të kishës në vende të ndryshme, krishtërimi ka, në një farë mase, shkatërruar kulturën, ruajtur atë, dhe si përfundim ka krijuar një kulturë të re në vend të së vjetrës. Kështu gjithandej të krishterët duhet të mendojnë seriozisht se si jeta e tyre e re në Krishtin duhet të lidhet me kulturën bashkëkohore.

Në letrat paraardhëse të Konsultës dy modele pak a shumë të ngjashme na u shtruan përpara. Dikush sugjeroi që ka disa kategori zakonesh të cilat duhet të dallohen. E para përfshin ato zakone të cilat prej të konvertuarit pritet që ti lërë prapa menjëherë si të papërputhshme me ungjilline krishterë (p.sh. idhujtaria, pronësia e sklevërve, shtrigëritë dhe fallrat, gjuetinë e kokave, gjakmarrjet, prostitucionin ritual, dhe të gjitha diskriminimet të bazuara në racë, ngjyrë apo ndarje shoqërore). Një kategori e dytë mund të përfshijë zakonet e institucionalizuara të cilat mund të durohen për një farë kohe, por pritet të zhduken gradualisht (p.sh. sistemet shtresore, skllavëria dhe poligamia). Një kategori e tretë mund të lidhet me traditat martesore, sidomos çështjet e gjakut të njëjtë, mbi të cilën kishat janë të ndara, ndërsa në një kategori të katërt mund të vendosim të ashtuquajturën *adiaphora* apo “çështje indiferente”, të cilat kanë lidhje vetëm me zakonet dhe jo me moralin, dhe si rrjedhim mund të ruhen pa ndonjë kompromis (p.sh. zakonet e ngrënies dhe larjes, format e përshëndetjes publike të gjinisë së kundërt, veshje dhe krehjet e flokëve, etj.).

Modeli i dytë që kemi konsideruar ndryshon midis takimeve “direkt” dhe “indirekt” të Krishtit dhe kulturës, të cilat kanë të bëjnë afërsisht me kategorinë e parë dhe të dytë të modelit tjetër. E zbatuar në studjimin e Fixhit të shekullit të 19, u morr në hamendje që do të kishte një “takim të dretpërdrejtë” me praktika kaq jonjerëzore si kanibalizmi, mbytja e vejshave, vrasja e fëmijëve, vrasja e etërve, dhe që të konvertuarit priteshin të braktisnin këto zakone sapo të konvertoheshin. Takime “indirekte” do të ndodhnin,

ose kur çështja morale nuk ishte e ndarë siç duhet (p.sh., disa zakone martesore, rite fillimi, festivale dhe festa muzikore që përfshijnë këngë, vallëzime dhe instrumente) ose kur duket qartë vetëm mbasi i konvertuari ka filluar të kuptojë besimin e tij ose të saj në jetën e aplikuar të krishterë. Disa nga këto zakone nuk duhet të hidhen poshtë, por të pastrohen nga elementë të papastër dhe të mbillen në kuptime të krishtera. Zakoneve të vjetra mund ti jepen kuptime të reja, vallëzimet e vjetra mund të kërcehen për bekime të reja, dhe punëdore të vjetra mund të shërbejnë për qëllime të reja. Duke marrë borxh një shprehje nga Dhjata e Vjetër, shpatat mund të farkëtohen në plugje dhe shtizat në thika krasitje.

Konventa e Lozanës tha: “Ungjilli nuk presupozon mbizotërimin e një kulture mbi ndonjë kulturë tjetër, por i mat të gjitha kulturat në bazë të kërkesave të veta të drejtësisë dhe vërtetësisë, dhe ngul këmbë në absolutet morale në çdo kulturë” (para. 10). Duam ta marrim përsipër këtë, dhe ta theksojmë madje edhe në kohën e sotshme të relativitetit që absolutet morale mbeten. Me të vërtetë, për kishat që studiojnë Shkrimet nuk duhet të jetë e vështirë të dallojnë çfarë i përket së parës apo kategorisë së “takimit direkt”. Parimet e Shkrimeve nën drejtimin e Shpirtit të Shenjtë do ti drejtojnë gjithashtu në lidhje me kategorinë e “takimit indirekt”. Një test shtesë i shtuar është të pyesim nëse një zakon e shton apo e zvogëlon jetën njerëzore.

Do të shihet që studimet tona janë fokusuar më tepër në situatat ku kishat e reja duhet të ngrihen kundër të ligave të caktuara. Por ne jemi rikujtuar që kisha duhet ti ballafaqojë të ligat edhe në kulturën perëndimore gjithashtu. Në perëndimin e shekullit të 20, shpesh herë shembuj më të komplikuar, por jo më pak të tmerrshëm të së ligës të cilat u ballafaquan në Fixhin e shekullit të 19 egzistojnë. Paralel me kanibalizmin është padrejtësia shoqërore e cila “ha” të varfërit; ndaj mbytjes të vejshave, shtypja e femrave; ndaj vrasjes së fëmijëve, aborti; ndaj vrasjes së etërve, injorimi i të moshuarve; ndaj luftës fisnore, lufta e parë dhe e dytë botërore; dhe ndaj prostitucionit ritual, përzierja seksuale. Duke marrë parasysh paralelizmin, është e nevojshme të kujtojmë si fajin e shtuar ndaj kombeve vetëm në emër të krishtera, dhe të protestave trime të së krishterëve kundër këtyre të ligave, dhe sukseset e mëdha (megjithëse jo të plota) të cilat kanë fituar luftën mbi të liga të tilla. E liga merr shumë forma, por është universale, dhe kudo që del në pah, të krishterët duhet ta ballafaqojnë dhe ta mundin.

C. Procesi i Ndryshimit Kulturor

Nuk është e mjaftueshme për të konvertuarit të dorëzojnë të ligat e kulturës së tyre; e gjithë kisha duhet punojë për eliminimin e tyre. Pra, rëndësia e pyetjes se si kulturat ndryshojnë nën influencën e ungjillit. Sigurisht, e liga dhe demonikja janë të ndërthurura thellë në shumicën e kulturave, dhe megjithatë Shkrimet thërrasin për pendimin tonë kombëtar dhe reformë, dhe historia shënon raste të shumta të ndryshimit kulturor për më mirë. Në fakt, në disa raste kultura nuk i reziston aq shumë ndryshimeve të duhura. Kujdes i madh duhet, megjithatë, kur kërkohet të fillojë.

Së pari, “njerëzit ndryshojnë kur dhe sa duan”. Kjo duket të jetë aksiomatike. Më tej, ata duan të ndryshojnë vetëm kur vërejnë të ardhurat pozitive të cilat ndryshimet sjellin në ta. Këto duhet të diskutohen me kujdes dhe të tregohen me durim, nëse të krishterët po mbrojnë në një komb në zhvillim përfitimet e mësimin të leximit ose vlerën e ujit të pastër ose në një komb perëndimor rëndësinë e një martesë dhe jete martesore të peshuar.

Së dyti, dëshmia ndër-kulturore në Botën e Tretë duhet të ketë respekt të madh për mekanizmat e ndërtuara të ndryshimit shoqëror në përgjithësi, dhe për “procedurat e duhura të ripërtëritjes” në çdo kulturë.

Së treti, është e rëndësishme të kujtojmë që pak a shumë të gjitha zakonet kanë role të rëndësishme brenda kulturës, dhe që edhe praktika të padëshiruara mund të kryejnë funksione “konstruktive”. Duke qenë kështu, një zakon nuk duhet të hidhet poshtë pa i kuptuar punën e tij dhe pastaj duke e zëvendësuar me një zakon tjetër që bën të njëjtën punë. Për shembull, mund të jetë e drejtë të duam të heqim disa rite fillimi të lidhura me rrethprerjen e adoleshentëve dhe disa nga format e edukimit seksual që e ndjekin. Kjo nuk është të mohosh që ka ndonjë vlerë në procesin e fillimit; kujdes i madh duhet të jetë kur gjenden zëvendësues të duhur për ritet dhe format e fillimit të cilat ndërjegjija e krishterë do që të shkatërrohen.

Së katërti, është thelbësore të njohim që disa praktika kulturore kanë një ndërthurje teologjike. Kur kjo ndodh, kultura do të ndryshojë vetëm kur teologjia ndryshon. Kështu, nëse vejjshat vriten në mënyrë që burrat e tyre të mos futen në botën tjetër të pandihmuar, ose nëse të moshuarit vriten përpara se mosha ti rëndojë, në mënyrë që në botën tjetër të jenë të fortë mjaftueshëm që të luftojnë dhe gjuajnë, atëherë vrajse të tilla, për arsye se janë të themeluara në eskatologji të rreme, do të braktisen vetëm me një alternativë më të mirë, shpresa e krishterë, do të pranohet në vend të saj.

Pyetje për diskutim

1. A mund të njihet “ngjashmëria me Krishtin” në çdo kulturë? Cilat janë pjesët e saj?
2. Në kulturën tuaj, çfarë do të prisnit që një i konvertuar i ri të dorëzonte menjëherë?
3. Gjeneronjë “zakon të institucionalizuar” në vendin tuaj të cilin të krishterët shpresojnë të “zhduket ngadalë” (p.sh. poligamia, sistemi shtresor, divorci i lehtë, apo ndonjë formë tjetër shtypjeje). Çfarë hapash aktivë duhet të ndër marrin të krishterët që të punojnë për ndryshim?

Përfundimi

Konsulta jonë nuk na ka lënë në dyshim fare për rëndësinë e kulturës. Shkrimi dhe leximi i Biblës, prezantimi i ungjillit, konvertimi, kisha dhe sjellja—të gjitha këto influencohen nga kultura. Është thelbësore, atëherë, që kishat të kontekstualizojnë ungjillin në mënyrë që a ndajnë atë me efektivitet në kulturën e tyre. Për këtë detyrë të ungjillizimit të gjithë ne e dimë nevojën e madhe të shërbesës së Shpirtit të Shenjtë. Ai është Shpirti i së vërtetës që mund ti mësojë çdo kishë të lidhet me kulturën e cila e rrethon. Ai është gjithashtu Shpirti dashurisë, dhe dashuria është “gjuha—të cilën e kuptojnë në çdo kulturë njerëzore.” Kështu na mbushtë Perëndia me Shpirtin e tij! Pastaj, duke folur të vërtetën në dashuri, do të rritemi në Krishtin i cili është koka e trupit, në lavdinë e përjetshme të Perëndisë (Efes. 4:15).

SHËNIM: Kuotime të pa dhëna meritë në këtë raport janë marrë nga letra të ndryshme të dhëna në këtë Konsultë.

Programi i Konsultës dhe Letrat

Janar 7 **Kultura dhe Zbulesa** (faktorët kulturorë në Bibël)

Dhjata e Vjetër: S. Ananda Kumar
Dhjata e Re: I. Howard Marshall
Drejt një Teologji Kulture: Bruce J. Nichols

Janar 8 **Kultura dhe Hermenautika** (të kuptuarit e Biblës sot)

Një Perspektivë Teologjike: C. Rene Padilla
Një Perspektivë Antropologjike: Charles R. Taber

Janar 9 **Kultura dhe Ungjillizimi** (përmbajtja dhe komunikimi i ungjillit)

Një Perspektivë Teologjike: James I. Packer
Një Perspektivë Antropologjike: Jacob A. Loewen

Janar 10 **Kultura dhe Konvertimi** (implikimet e kulturës në përjetimin e konvertimin)

Gjëndja Afrikanë-Lindore: Donald R. Jacobs
Përmasat Teologjike Nga Një Perspektivë Koreane: Harvie M. Conn
Një Studim Personal: Orlando E. Costas

Janar 11 **Kultura dhe Kishat** (kishat e krishtera dhe zhytja e tyre në kulturë)

Modeli i Njësisë Dinamike: Charles H. Kraft
Një Kritikë Social-Historike: Alfred C. Krass
Një Studim nga Indonezia: I. Wayan Mastra

Janar 12 **Kultura dhe Etika** (kontekstualizimi i ungjillit në sjelljen e krishterë)

Jetesa e Krishterë: Gottfried Osei-Mensah
Një studim nga Oceania: Alan R. Tippett

Letra sfondi

Feja dhe Kultura, një Përmbledhje Historike: Stephen C. Neill
Konvertimi dhe Konvertimiteti, në lidhje me Muslimanët: Kenneth Cragg

Të Pranishëm

PJESËMARRËSIT(Firmosësit e Konventës së Lozanës dhe/ose besnikë ndaj skemës së saj dhe kuptimit të misionit)

Dr. Saphir Athyal, Drejtues (President) i Union Biblical Seminary, Yavatmal, Indi

Dr. Kwame Bediako, Lektor në Studime Biblike dhe Teologji, Christian Service College, Kumasi, Gana

Prof. Dr. Peter P.J. Beyerhaus, Profesor i Misiologjisë dhe Ekumenizmit, Tubingen University, Gjermania Perëndimore

Prof. Robinson Cavalcanti, Profesor i Shkencave Politike në Recife Federal and Rural Universities of Pernambuco, Brazil

Dr. Chongnam Cho, President dhe Profesor, Seoul Theological Seminary, Bucheon City, Kore

Dr. Harvie M. Conn, Ndhmës Profesor i Misioneve dhe Apologjetikës, Westminster Theological Seminary, Chestnut Hill, Filadelfia, Pensilvani

Rev. Dr. Orlando E. Costas, Drejtor, Latin American Evangelical Centre for Pastoral Studies (CELEP), San Jose, Kosta Rika

Mr. Edward R. Dayton, Drejtor, MARC, Monrovia, Kaliforni
Cand. Theol. Tormod Engelsviken, Mësues Teologjie, Fjellhaug School of Missions, Oslo, Norvegji
Dr. John A. Gration, Ndhmës Profesor i Misioneve, Wheaton Graduate School, Wheaton, Illinois
Dr. Donald R. Jacobs, Drejtor, Mennonite Christian Leadership Foundation
Dr. F.S. Khair-Ullah, Drejtor, Creative Writing Project of M.I.K., Pakistan
Dr. Charles H. Kraft, Profesor i Antropologjisë dhe Studimeve Afrikane, School of World Mission, Fuller Theological Seminary, Pasadena, Kaliforni
Rev. Dr. S. Ananda Kumar, Profesor i Studimeve biblike, Karnataka Theological College, Karnataka State, India Jugore
Dr. Jacob A. Loewen, Konsultant Përkthimesh për Afrikën Lindore Qëndrore me United Bible Societies
Dr. I Howard Marshall, Lexues në Egzegezën e Dhjatës së Re, University of Aberdeen, Skoci
Dr. I. Wayan Mastra, Kryesues i "Gereja Kristen Protestan di Bali," Indonezi
Mr. Bruce J. Nicholls, Sekretar Ekzekutiv, Theological Commission, World Evangelical Fellowship
Rev. Gottfried Osei-Mensah, Sekretar Ekzekutiv, Lausanne Committee for World Evangelization
Rev. Dr. James I. Packer, Ndhmës Drejtor, Trinity College, Bristol, Angli
Dr. C. Rene Padilla, Drejtor i Ediciones Cereteza, International Fellowship of Evangelical Students
Dr. William E. Pannell, Ndhmës Profesor i Ungjillizimit, Fuller Theological Seminary, Pasadena, Kaliforni
Rev. Pedro Savage, (Kordinator i Konsultës), Kordinator, Latin American Theological Fraternity, anëtar stafi i Partnership in Mission and of Latin American International Fellowship of Evangelical Students
Rev. John Stott, (Drejtor Konsulte), Rector Emeritus, All Soul's Church, Langham Place, Londër
Dr. Charles R. Taber, Drejtor, Institute of World Studies / Church Growth, Milligan College, Tennesi
Rev. Tite Tienou, Drejtor i Bible School Bobo Dioulasso, Upper Volta, dhe Sekretar Ekzekutiv i A.E.A.M. Theological Commission
Dr. Alan R. Tippett, Hon. Research Fellow, St. Mark's Library, Canberra, Australi
Rev. Canon James Wong, Pastor Anglikan dhe Kordinator i Asian Leadership Conference on Evangelism, Singapur
KONSULTANTË (në simpati të përgjithshme me Konventën e Lozanës)
Bishop Kenneth Cragg, Lexues në Religious Studies, University of Sussex, and Ndhmës Peshkop i Chichester, Angli
Rev. Alfred C. Krass, Bashkë-Editor i revistës *The Other Side*
Canon Prof. John Mbiti, Drejtor i Ecumenical Institute, Bossey, i World Council of Churches, Gjenevë, Svicër
Bishop Stephen Neill, Resident Scholar, Wycliffe Hall, Oksford, Angli
VIZITOR (Kontribuon ndaj një Konsultimi i dedikuar Koventës së Lozanës)
Rev. Louis J. Luzbetak, President, Divine World College, Epworth, Iowa.